



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 136, shkurt 2015

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

KOMUNIKATË

LETËR MËQËSORE

Kryesia e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" në mbledhjen e saj, datë 12 shkurt 2015, dite enjte, në vijim të punës së saj për ngritjen e përmendoreve, të patriotit Mehmet Shpendi dhe albanologut Martin Camaj, del me këtë komunikatë:

E ndjenë për detyrë të komunikojnë më të gjithë anëtarët e shoqatës, dukagjinastit kudo që ndodhen, dashamirët e Dukagjinit dhe dukagjinastve, biznesmenët dukagjinast dhe jo dukagjinast dhe të gjithë të interesuarve për mbrojtjen dhe vlerësimin e historisë dhe kulturës në Shqipëri, vlerësimin e figurave që gjithë jetën e tyre ja kushtuan krahinës, Shqipërisë dhe shqiptarëve, pa asnjë dallim, pa ndarje apo veçime.

Që në themelimin e saj, në programin dhe statutin e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" janë shpallur parësore çështja e vlerave të mira të trashëguara në shekuj, vlerësimin e atyre që nuk kursyen asgjë në shërbim të krahinës dhe Shqipërisë. Është bërë prej kohësh punë shumë e madhe hulumtuese dhe vlerësuese në këtë drejtim, janë zhvilluar konferenca dhe simpoziume shkencore, duke publikuar ngjarje e figura që vërtetë janë me shumë vlerë për sot dhe për të ardhmen, veçanërisht për brezi e ri dhe ata qëvinë.

Kemi dy vjet që kemi programuar dhe punuar për përkujtimin e dy figurave nga më të rëndësishmet, më të pa përsëritshmet që ka Dukagjini, për ngritjen tyre në pedestalin që e meritojnë, në pedestalin që e fituan me mendjen dhe gjakun e tyre, në pedestalin që u ka dhënë historia. Këto figura të ndritura janë patrioti Mehmet Shpendi dhe albanologu Martin Camaj.

Atdhetari Mehmet Shpendi, figurë qendrore për shumë vite e Dukagjinit në krahinë dhe jashtë saj, për lirin dhe përparimin e vendit, 100 vjet më parë u kap me pabesi dhe u pushkatua në ballë të rezistencës së Dukagjinit, në Plan të Pultit, duke mos pranuar presionet e ushtrisë pushtuese Serbo-Malazeze, që të thyhej dhe t'u vihet në shërbim pushtuesve. Albanologu Martin Camaj figurë e madhe e kulturës shqiptare, kundërshtar i vendosur i regjimit komunist, lëvrues i palodhur i gjuhës shqipe, personalitet i nderuar kudo që punoj dhe jetoj në emigrim. Martin Camaj nuk pushoj asnjë herë, deri në vdekje së punuar në shërbim të kulturës shqiptare, jo vetëm si profesor në universitete, por edhe si shkrimtar gjithnjë me tema nga Dukagjini dhe Shqipëria.

Për këto dy figura janë arritur marrëveshjet dhe është marrë vendimi nga Këshilli i Bashkisë Shkodër që të vendosen në qytetin e Shkodrës si dhuratë që Shoqata "Atdhetare Dukagjini", dukagjinastit, dashamirët e Dukagjinit dhe gjithë dashamirësit e historisë dhe kulturës shqiptare i bëjnë këtë qytetit të bukur dhe me vlera të papërsëritshme në të gjitha drejtimet.

Ka filluar mbledhja e fondeve për ngritjen e monumenteve. Ndjehe mi shumë të entuziazmuar për punën shumë të mirë, të organizuar në mënyrë shembullore nga komuniteti dukagjinast në Neë Jorkun e SHBA. Një grup organizator shumë i kujdesshëm, punëtor dhe i vendosur, larg fjalëve të shumta, por punëmëdhenj, që drejtohet nga një këshill shumë aktiv në krye të të cilit është Tomë Balbona. Nga puna e mirë e këtij këshilli i janë bashkangjitur këtyre dhuruesve edhe shumë shqiptarë që ndonëse nuk janë me prejardhje nga Dukagjini, kanë dhënë me bujar ndihmesën e tyre. Na vjen shumë mirë dhe ndjehe mi shumë të mobilizuar kur shikojmë se në këtë organizim në New Jork janë bashkangjitur edhe shumë dukagjinast që tashmë janë të brezit të katër apo edhe më shumë që janë larguar nga vendlindja, të cilët nuk e kanë harruar aspak tokën amë, dheun e të parëve. Fondet e mbledhura deri tash, nga ky komunitet, janë një garanci dhe shpresë se objektivi ynë do të realizohet me sukses.

Ne i falënderojmë me gjithë fuqinë e zemrës dhe të mendjes!

Shembulli i tyre pa tjetër që është dhe do të bëhet nxitje edhe për të tjerët. Kemi kontaktuar me shumë bijë dhe bija dukagjinast në vende të ndryshme të botës, kemi marrë mbështetje dhe kanë filluar lëvizjet dhe organizimet në këtë drejtim. Presim më shumë punë, lëvizje e rezultate brenda vendit nga të gjithë. Ne jemi të bindur se së bashku do ta plotësojmë këtë objektivi për të cilin historia do ta vlerësojë punën tonë, brazat që vinë do të na kujtojnë. Ju bëjmë thirrje dukagjinastve kudo ndodhen, biznesmenëve dukagjinast dhe më gjere, që të bëhen pjese e kësaj nisme, për të kontribuar për ndërtimin e këtyre dy monumenteve dhe brenda muajit shkurt të japin kontributin e tyre. Mbetemi të mobilizuar së bashku për ta mbyllur me sukses këtë mision që kemi marre përsipër së bashku, sepse tashmë të gjithë jemi pjese e kësaj nisme.

**Me respekt e mirënjohje për të gjithë!
KRYESIA E SHOQATËS "ATDHETARE DUKAGJINI"
Shkodër, më 12.02.2015**

Të dashur dhe të respektuar intelektual dukagjinast dhe jo dukagjinast, dashamirës të historisë dhe kulturës dukagjinaste!

Të dashur dhe të respektuar biznesmenë Dukagjinast brenda dhe jashtë Shqipërisë!

Të dashur dhe të respektuar të afërm të Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt!

Te dashur dhe të respektuar dashamirës të Dukagjinit dhe dukagjinastve!

Të dashur dhe të respektuar dashamirës të veprës së pavdekshme të Mehmet Shpendit dhe të Martin Camajt!

Te dashur dhe të respektuar dashamirës të historisë dhe kulturës dukagjinaste dhe gjithë Shqipërisë!

Të dashur dhe të respektuar drejtues të degëve të Shoqatës "Atdhetare Dukagjini"!

Prej disa kohe, me nismën e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", është vënë në plan të parë për shoqatë dhe komunitetin dukagjinast kudo që ndodhen, ngritja e përmendoreve të atdhetarit Mehmet Shpendi dhe albanologut Martin Camaj. Edhe pak muaj na ndajnë nga 100 vjetori i kapjes në pabesi dhe vrasjes në ballë të frontit të Mehmet Shpendit dhe trimave dhe trimëshave të tjerë në rezistencën e malësorëve dukagjinast në Plan të Dukagjinit, në korrikun e vitit 1915, por edhe 90 vjetori i lindjes së Martin Camajt. Siç edhe mund të jeni në dijeni, kemi kërkuar hapur dhe me transparencë ndihmë financiare dhe jemi në momentin më final të realizimit të kësaj nisme. Koha nuk pret, ajo po ecën me shpejtësi, ose të paktën kështu po na duket në këto momente.

Është koha që të gjithë të mobilizohemi, të tregojmë dashurinë për të parët tonë që e ruajtën këtë tokë, të parët tonë që shkruan dhe publikuan vlerat e kësaj toke që është njomur me gjakun e të parëve tonë ndër shekuj. Të gjithë kemi marrë dhe marrim pjesë në diskutimet kudo ndodhemi dhe tregojmë dashurinë që kemi dhe duhet të kemi për vendlindjen, për të parët tonë, për bëmat e tyre të mira, të gjithë duam që tua tregojmë edhe të tjerëve dhe veçanërisht brezit të ri dhe atyre që do të vinë, historinë tonë të mirë në të gjitha aspektet e jetës, të gjithë, kush më shumë dhe kush më pak, japim këshilla, dhe tregohemi të gatshëm për të ndihmuar sa herë që të jenë nevoja. Sot ka ardhur koha që të tregojmë veten, natyrisht sipas mundësive, me qëllim që të mundësojmë në kohën e duhur grumbullimin e fondeve për këto përmendore, sepse si çdo punë edhe kjo kërkon kohën e vet. Të gjithë ata që e gjejnë veten në këto momente në frontin e vlerësimit të historisë dhe kulturës dukagjinaste dhe më gjerë, të gjithë ata që duan të vlerësojnë parardhësit e tyre në shërbim të krahinës dhe atdheut, është koha të afrohem pranë shoqatës, pranë njëri-tjetrit, për të ndihmuar, tu drejtohen bankave, tu drejtohen organeve drejtuese të shoqatës për të bërë dhuratën e vet, gjithmonë në sasinë e dëshiruar, por dhe të mundur.

Në këto momente kanë mbaruar fjalët, tashti kërkohen vetëm veprime praktike, grumbullim fondesh. Shembullin shumë të mirë e kemi. Vëllezërit tonë, bashkëkrahinarët tonë, por edhe të tjerë jo me origjinë nga Dukagjini, në Neë Jork të SHBA, kanë bërë një punë shumë të mirë edhe organizative. Kjo ka sjell si rezultat grumbullimin e gati 50% të fondeve për këto përmendore. Ne, duhet ti përgëzojmë, kjo po e po, por edhe të bëhemi pjesë aktive. Shoqata "Atdhetare Dukagjini" ju drejtohet drejtpërdrejt për tu përfshi në grumbullimin e fondeve. Tash është koha më shumë se asnjëherë deri në sot, për të respektuar historinë dhe kulturën e krahinës së

Dukagjinit, për ta vënë në pedestalin e merituar.

Po nuk u vendosën këto përmendore këtë verë në vendin e caktuar, do të humb aktualiteti, do të humbin vlera dhe do të tregohemi që kemi mangësi afrimi e bashkëpunimi me njëri tjetrin.

Besojmë në mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe ndihmën tuaj.

Për çdo gjë mund të kontaktoni me e-mail: nduesanaj@yahoo.it dhe luigjshyti@yahoo.it; me numër telefoni: 00355 692328116 dhe 00355 692465784. Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" mban llogarinë me bankën "UNIONBANK"-dega Shkodër, me numër llogarie:

Ne lekë: AL 2821 4511 0205 1036 7047 0201 12

Ne euro: AL 2221 4511 0205 1036 7047 0201 22

Ne dollarë: AL 1021 4511 0205 1036 7047 0201 45

Komisioni i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", për ndjekjen e realizimit të kësaj nisme:

1. Luigj Shyti, Kryetar; 2. Roza Pjetri, anëtar; 3. Lazer Stani, anëtar; 4. Prele Milani, anëtar; 5. Luigj Mila, anëtar. Kemi besim se do të jemi bashkë në realizimin e kësaj nisme dhe në përrurimin e këtyre përmendoreve.

**Me dashamirësi dhe me shumë respekt për të gjithë!
KRYESIA E SHOQATËS "ATDHETARE DUKAGJINI", Shkodër, më 15.02.2015**



MISION QË DUHET KRYER

MEHMET SHPENDI DHE MARTIN CAMAJ I BËJNË NDERË, SHKODRËS, DUKAGJINIT DHE GJITHË SHQIPËRISË

Që në themelimin e saj, në programin dhe statutin e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" janë shpallur parësore çështja e vlerave të mira të trashëguara në shekuj, vlerësimin e atyre që nuk kursyen asgjë në shërbim të krahinës dhe Shqipërisë. Është bërë prej kohësh punë shumë e madhe hulumtuese dhe vlerësuese në këtë drejtim, janë zhvilluar konferenca dhe simpoziume shkencore, duke publikuar ngjarje e figura që vërtetë janë me shumë vlerë për sot dhe për të ardhmen, veçanërisht për brezi e ri dhe ata që vinë.

Prej disa kohe, me nismën e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", është vënë në plan të parë për shoqatën dhe komunitetin dukagjinasi kudo që ndodhen, ngritja e përmendoreve të atdhetarit Mehmet Shpendi dhe albanologut Martin Camaj. Edhe pak muaj na ndajnë nga 100 vjetori i kapjes në pabesi dhe vrasjes në ballë të frontit të Mehmet Shpendit dhe trimave dhe trimëreshave të tjerë në rezistencën e malësorëve dukagjinasi në Plan të Dukagjinit, në korrikun e vitit 1915, por edhe 90 vjetori i lindjes së Martin Camajt. Siç edhe mund të jeni në dijeni, kemi kërkuar hapur dhe me transparencë ndihmë financiare dhe jemi në momentin më final të realizimit të kësaj nisme. Koha nuk pret, ajo po ecën me shpejtësi, ose të paktën kështu po na duket në këto momente. Është në nderin e secilit për të kontribuar, sepse jo vetëm do të nderojmë veten, por do të nderojmë historinë tonë, do të respektojmë brezat që do vinë. Do të jete krenari për secilin nga ne, që në qytetin e Shkodrës, në qendrën e Metropolit të Veriut të jenë prezent në çdo kohë dukagjinasi nëpërmjet këtyre dy figura me kontribute të jashtëzakonshme në themelet e kësaj Nënëlokeje, që e ka emrin Shqipëri.

Ne falënderojmë zotin Mark Dreni i cili inicioj fillimin e punës, vëllezërit tonë dukagjinasi në New York, që përkrahën dhe po mbështesin nismën tonë për ndërtimin dhe vendosjen e monumenteve të këtyre dy figura të ndritura të Dukagjinit

dhe shumë më gjerë, në qytetin Shkodër, por dhe këshillin e zgjedhur dhe kryetarin e tij, Tomë Balbona. Ky këshill është i organizuar shumë mirë, është shumë i kujdesshëm, punëtor dhe i vendosur, larg fjalëve të shumta, por punëmëdhenj e shumë aktiv. Nga puna e mirë e këtij këshilli u janë bashkangjitur këtyre dhuruesve edhe shumë shqiptarë që ndonëse nuk janë me prejardhje nga Dukagjini, kanë dhënë me bujari ndihmesën e tyre.

Siç thuhet në shkrimet shenjete për përhapësit e fesë së krishterë "... për punën që po bëni do tu kujtojnë njerëzimi" Ju të dashur vëllezër që po ndihmoni dhe do të ndihmoni për realizimin e këtij misioni do të kujtoheni nga historia, Dukagjini dhe Shqipëria do të kujtoheni nga brezat për punën që bëni. Bashkë jemi më të mirë dhe më të fuqishëm.

Shoqata do të mundësojë të gjithë mekanizmat, në mënyrë transparente, për evidentimin menaxhimin e plotë dhe me përgjegjësi, gjë e cila do të bëhet publike, herë pas here, apo edhe me kërkesë personale apo kolektive të dhuruesve, si një vlerësim dhe respekt për ta.

E ndjejmë veten më shumë krenar dhe them me plot bindje që kemi bërë mirë, shumë mirë që kemi marrë këtë nisem, për të vendosur këto dy përmendoreve.

"Pushka e Mehmet Shpendit për lirinë e Shqipërisë gjëmoj prej Shkupit e deri në Deçiq e penda e Martin Camajt, s'ndaloj së shkruari për 40 vjet duke evidentuar vlerat tona e krijuar vlera.

Këta dy burra të shquem dhënë gjithçka për Shqipërinë e lirë e për fjalën e lirë. Ne të gjithë duhet të japim diçka për të ruajt kujtimin e tyre. Kemi besim të plotë se këtë verë do të hijeshohen dy sheshe në Shkodër e se vepra e tyre do të frymëzojnë brezat e sotëm dhe ardhshëm" – shkruan Tomë Balbona. "Ushhtarë" është vështirë për të gjetur, më thoshte një miku im nga larg, ndërsa "komandantë" sa të duash. Edhe komandantët, pa asnjë diskutim kanë rëndësi në organizimin dhe drejtimin e punës, "luftës", por sot kemi shumë nevojë për "ushhtarë", sepse vetëm më komandantë nuk fitohet beteja. Sot na duhen thjeshtë para, këtu ka ardhur

momenti, këtij momenti duhet ti përgjigjemi. Koha po kalon, madje shumë shpejt, ajo po rrjedhë vrullshëm në këto momente. Nuk duhet ta lëmë për në momentin e fundit, sepse që të arrihet objektivi, misioni, do kohën e vet.

Ka dy vjet që kemi programuar, si shoqatë, punën për përkujtimin e këtyre dy figurave madhore, figurave qendrore të historisë dhe kulturës të krahinës dhe vendit, Mehmet Shpendin dhe Martin Camajt.

Të gjithë kemi marrë dhe marrim pjesë në diskutimet kudo ndodhemi dhe tregojmë dashurinë që kemi dhe duhet të kemi për vendlindjen, për të parët tonë, për bëmat e tyre të mira, të gjithë duam që tua tregojmë edhe të tjerëve dhe veçanërisht brezit të ri dhe atyre që do të vinë, historinë tonë të mirë në të gjitha aspektet e jetës, madje ka edhe nga ata që bëjnë "heroin", ashtu siç ka edhe nga ata që bëjnë "viktimën", të gjithë, kush më shumë dhe kush më pak, japim këshilla, dhe tregohemi të gatshëm, në biseda për të ndihmuar sa herë që të jenë nevoja. Sot ka ardhur koha që të tregojmë veten, natyrisht sipas mundësive, me qëllim që të mundësojmë në kohën e duhur grumbullimin e fondeve për këto përmendore.

Të gjithë ata që e gjejnë veten në këto momente në frontin e vlerësimit të historisë dhe kulturës dukagjinase dhe më gjerë, të gjithë ata që duan të vlerësojnë paraardhësit e tyre në shërbim të krahinës dhe atdheut, është koha të afrohem pranë shoqatës, pranë njëri-tjetrit, për të ndihmuar, tu drejtohen bankave, tu drejtohen organeve drejtuese të shoqatës për të bërë dhuratën e vet, gjithmonë në sasinë e dëshiruar, por dhe të mundur.

Në këto momente kanë mbaruar fjalët, tashti kërkohen vetëm veprime praktike, grumbullim fondesh.

Shembullin shumë të mirë e kemi. Vëllezërit tonë, bashkëkrahinarët tonë, por edhe të tjerë jo me origjinë nga Dukagjini, në New York, kanë bërë një punë shumë të mirë organizative. Kjo ka sjell si rezultat grumbullimin e mbi 50% të fondeve për këto përmendore. Edhe vëllezërit dhe bashkëkrahinarët tonë në Miçigan e kanë vlerësuar seriozisht këtë nisem dhe po

grumbullojnë fonde duke arritur shuma të konsiderueshme dhe puna po vazhdon me vrull. Shembull të shkëlqyer kemi edhe këtu në Shkodër. Intelektuali Kolë Çardaku nga Nica Shalë në Dukagjin, dhuron 5.000.000 lekë (të vjetra) për këto përmendore, po kështu ka dhënë ndihmesën e vet Prekë Gila nga Abati me banim jashtë shtetit, por edhe intelektual jo dukagjinasi po bëhen pjesë e kësaj nisme, po vlerësojnë figurën e Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt, dhe po kontribuojnë në grumbullimin e fondeve siç është rasti i zotit Alfred Haxhari, dhe kemi të dhëna se edhe shumë të tjerë do të përfshihen së afërmi. Ne, duhet dhe i përgëzojmë, kjo po e po, por edhe duhet të bëhemi sa më shumë pjesë aktive e tyre.

Shoqata "Atdhetare Dukagjini" ju drejtohet drejtpërdrejt për tu përfshi në grumbullimin e fondeve. Tash është koha për të respektuar historinë dhe kulturën e krahinës së Dukagjinit, për ta vënë në pedestalin e merituar.

Kur Kryesia e Shoqatës Atdhetare Dukagjini mori nismën e guximshme për ndërtimin e përmendoreve të Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt nuk kishim para. Ka edhe nga miqët tonë që e quajtën këtë nisem me mundësi të pakta për tu realizuar. Ka ardhur koha që ti lëmë fjalët dhe fjalimet dhe të fusim dorën në xhep. Ka qenë zakoni në malet tona kur dikush ka filluar të ndërtojë një shtëpi, të gjithë katundi e ka ndihmuar me çfarë kishin mundësi. Kjo duhet bërë edhe në këtë rast.

Dukagjini ka qenë dhe është pjesë politike, ekonomike, shoqërore dhe shpirtërore e Shkodrës. Populli, domosdoshmërisht duhet të nderojnë heronjtë e vet, përndryshe s'ka si të quhet i till.

Kemi nevojë për këshilla dhe mendime të çdo dashamiri, të cilat i kemi vlerësuar dhe i vlerësojmë vazhdimisht, por sot kemi nevojë urgjente për ndihma financiare, për realizimin e përmendoreve të këtyre figurave shumë të veçanta, shumë të çmuara dhe shumë gjithëpërfshirëse.

Ne duhet ta duam krahinën, vendin, historinë dhe kulturën ashtu siç e deshën ata që në themelet e tij vunë mendjen, jetën, gjakun dhe trupin e tyre, por edhe siç e duan dhe u duhet

brezave që do të vinë.

Nuk po kërkohet jeta dhe gjaku i askujt por thjeshtë një ndihmë financiare, sipas zëmërës dhe mundësisë. Xhepi dhe zemra duhet të nxisin njëri tjetrin.

Që të arrijmë në fund nuk duhet të qëndrojmë në vend dhe të presim, duhet të ecim, ecja të nxjerr në krye. Në një film nga vende të largëta thuhet se jeta ka të sajat. E shikon vetën të rrezuar për tokë dhe hidhërohesh, e shikon veten në majë dhe ngazëdhehesh. Reagimi në të dy rastet është gabim. E rëndësishme është të ecësh përpara.

Çdo kush mund të bien, por i lumtur është ai që ngrihet përsëri. Shpirti i trimave dhe trimëresha që bien në tokën e atdheut, që vënë jetën në shërbim të atdheut, ndjejnë qetësi vetëm atëherë kur mundi, dituria, jeta, gjaku i tyre nuk shkon kot, por kujtohet, vlerësohet dhe ngrihet në pedestalin e merituar, vendosen në altarin e atdheut dhe historisë.

Puna e shkëlqyer e deri tashme e vëllezërve tonë, por edhe të dashamirëve të tjerë, është dhe duhet të jenë shumë mobilizuese, shumë shpresëdhënëse se së afërmi do të shikojmë të ngritura këto përmendore në qytetin tonë të dashur e të bukur, në Shkodrën tonë. Do të jetë krenari për secilin nga ne, që në qytetin e Shkodrës, në qendrën e Metropolit të Veriut të jenë prezent në çdo kohë dukagjinasi nëpërmjet këtyre dy figura me kontribute të jashtëzakonshme që nuk kursyen asgjë për Nënëloken Shqipëri.

Kjo nisem është një mision dhe këtë mision duhet ta kemi të gjithë në qendër të vëmendjes, veçanërisht, ne, Dukagjini dhe dukagjinasi, bijtë e të cilit po vendosen në pedestalin e historisë. Ne, nuk po u falim atyre asgjë nga xhepi apo puna jonë, asgjë të pa qenë, asgjë që nuk e meritojnë. Me këtë veprim po kryejmë një shërbim ndaj të sotmes dhe brezave që do të vinë, ndaj krahinës dhe kombit.

Përmendoret e Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt i bëjnë nderë, Shkodrës, Dukagjinit dhe gjithë Shqipërisë.

Luigj SHYTI

Kryeredaktor i gazetës "DUKAGJINI"

NDUE MARASHI - BIR I DUKAGJINIT

“ORA E TIJ PUNONTE NË KRAHUN E DASHURISË HUMANE”



- Kam ardhë me takue djalin para se të nisët me pushime në Vlorë - i pat thënë shërbëtores nëna e Ndue Marashit.

- Kryetari po fle dhe nuk duhet ta shqetësoni, ejani në darkë - iu përgjigj prerë shërbyesja, e cila ishte emëruar nga shteti në këtë post për të punuar pranë familjes së Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës.

Dhe nëna e Ndues, bija e Shllakut, i kthej shpinën asaj shtëpie dhe djalit që “flinte” për të mos e parë kurrë më të gjallë.

Ishte data 16 dhjetor 1975. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës, Ndue Marashi kthehet nga zyra për në shtëpi rreth orës 10.00, për t’u përgatitë për një pushim disa ditore në Vlorë bashkë me të shoqen, Françesken, pasi kjo e fundit katër ditë me parë ishte goditë në kokë në mënyrë banditeske nga njerëz që nuk u identifikuan kurrë, në kohën që la punën e shkante në shtëpi në këmbë rreth orës 7 të darkës. “E kanë me mue” i pat thanë Nduja.

Në orën 11. 00 të po të asaj dite të 16 dhjetorit 1975 dëgjohej një krismë e vetme arme në shtëpinë e Kryetarit, të cilën e kishin dëgjuar komshinjtë si dhe nga proces-verbali i policisë, del se i vdekuri ishte Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të rrethit Tiranë, Ndue Marashi, që me një komunikatë të lëshuar nga vetë kryeministri i asaj kohe, Mehmet Shehu, pohohej publikisht të nesërmen me 17 dhjetor, në formë denigruese se “bajraktari i fshatrave të Tiranës është vetëvrasë”, duke vazhduar me pas me mediat, të cilat lajmëruan se Ndue Marashi ka vrasë vetën me pistoletën e punës me një plumb të vetëm në ballë. Komunikata ishte pa komente, por thjeshtë sa për dijeni. Mos të harrojmë se është ky Kryeministër, që flet me hysterizëm kundër personalitetit të veriorit Ndue Marashi, i cili 6 vjet më vonë do të provonte këtë fat mbi kokën e vet.

Në momentin e vrasjes së Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës, Ndue Marashi, askush nuk ndodhej në shtëpi; bashkëshortja do të blinte cigare për të shoqin të një kinkaleri te sheshi “Avni Rustemi”, për udhëtimin e nesërm, ndërsa shërbyesja kishte ikë për të “blerë bukë”, kur kësaj të fundit nuk i lejohej të largohej nga shtëpia asnjë çast. Komshinjtë në fillim deponuan se kishin parë dy persona te dera e shtëpisë, që u larguan me një motor, pikërisht pas dëgjimit të krismës së armës (kush mbante motor në atë kohë?), por më vonë u tërhoqën duke thënë se nuk kishin parë gjë. Sapo u kthye në shtëpi e shoqja e Ndues, Françeska, dhe mori vesh lajmin e kobshëm, tha: “Ma vrasë Ndue” duke iu drejtuar hetuesve e sigurimsave, që merreshin me rrethanat e vrasjes. Këtë thënie, me gjithë presionin e kërcënimit, që iu benë, ajo nuk e mohoi kurrë, as para Feqor Shehut, as në hetuesi, as në tortura, as në internim, as edhe sot e kësaj dite.

Ndue Marashi u lind në rrethinat e Shkodrës me 1933. Familja e tij ishte shpërngulur nga Dushmani (lagja Malagji) dhe ra në qytet

si shumë familje dukagjinase për ti shpëtuar varfërisë e duke kërkuar një jetë më të mirë.

Kur Ndoja nuk ishte as gjashtë vjeç, me 1939, familja bën lëvizjen e dytë dhe kësaj radhe në drejtim të Tiranës në lagjen e Bamit, që në atë kohë ishte vetëm një fushë me ferra e driza, si dhe një pjesë e varrezave të qytetit. Në këtë lagje me vëllezër e motra e në varfëri hedh shtat numri një i ardhshëm i Tiranës, Ndue Marashi. Njerëzit dhe komshinjtë si Kokonozet, Shehet e te tjerë, flasin fjalët më të mira për këtë familje, për shpirtin solidar, për urtësi e integritet në shoqëri. Nduja i vogël ishte inteligjent nga natyra, por nuk mund të vazhdonte shkollën direkt, pasi ishte me i madhi i fëmijëve e kështu gjen një punë e nga këtu fillon të arsimohet pa shkëputje, për disa vjet rresht. Direkt nga prodhimi i ngjitët dijes duke mbaruar me rezultate të shkëlqyera shkollën bujqësore, në degën Zooteknikë. Aftësitë, vetëm të tijat; energjia në punë, aftësia drejtuese dhe mbi të gjitha karakteri i tij, bëjnë që sapo mbaroi fakultetin të emërohej drejtor i konvikteve të Institutit Kamzë dhe me vonë bëhet pedagog në këtë institut. Shpejt, Ndue Marashi do të përfshihet në nomenklaturën drejtuese duke filluar, së pari si kryetar i kooperativës bashkuar të Kasharit. Në këtë detyrë merr nderimin e gjithë fshatarëve duke qenë krah për krah me ta në punë e shtëpi, në dasma, gëzime e morte. Ai diti të fitojë respekt sa askush tjetër, ku edhe sot nuk del një banor i kohës tij të thotë një diçka të keqe për këtë kuadër, përkundrazi ata e kujtojnë plot nderim. Ai rriti rezultatet e të ardhurat për krahë pune e mbi të gjitha barazoi klasat duke mos përfillur biografisë. Potencia organizuese dhe aftësia për t’u zgjidhë hallet populit e sjellin Ndue sekretar të parë të partisë për Rajonin Nr. 4 të Tiranës, i cili kishte në vartësi të gjitha fshatrat. Emri i tij filloi të lakohej në skajet ma të largëta të rrethit dhe në vatrata të varfra duke u sjellur besim në zgjidhjen e halleve e problemeve që kishin njerëzit. Në këta vite dëgjohehin këshillat që qytetarët e fshatarët u jepnin njëri-tjetrit: “Shko te Ndue Marashi, se ai ta zgjidh problemin”. Kështu sekretari i parë cakton një ditë në dy javë për takim direkt me popullin. Fjala e tij ishte shpatë dhe zgjidhja e problemit e sigurt. Puna po i jepte rezultate dhe në vitin 1970 zgjidhet Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës. Vështirësi e del me gjoks, pasi dikasteri kishte shumë mangësi e burokraci që kërkonin zgjidhje urgjente. Përsëri njerëz hallexhin pas dera për takim me kryetarin, e përsëri një ditë në dy javë takim me popullin. Ishin këta vite që njerëzit kishin filluar të humbnin besimin te dikasteret për shkak të një burokracie të tepruar dhe papërgjegjësie që kishin kuadrot, për shkak të frikës e të pa aftësisë së tyre për të vepruar në pavarësi e me kompetencë dhe për këtë i vetmi që mund t’i ndihmonte dhe t’u zgjidhte hallet e t’u vinte në ndihmë ishte vetë Kryetari.

Në shtator të vitit 1973 edhe unë, autori i këtij shkrimi, i shkova në takim kryetarit Ndue Marashi për të zgjidhë një padrejtësi që enti i banesave i kishte bërë repartit tonë të helikopterëve. Sa për kuriozitet, në këtë kohë Komiteti Ekzekutiv i Tiranës ishte në mes të sheshit, para Pallatit të Kulturës ku është sot Muzeu Kombëtar. “Ka arde shoku i helikopterëve”, i tha sekretarja. Ai u ngrit në këmbë e m’tha dorën. “Prej nga je?”, - m’tha duke parë emrin tim verior në kartë vizitë. (kujtoj që në këto vite ishin shumë pak verior që banonin në Tiranë). “Prej Komani”, - iu përgjigja si me krenari. “O po, ai fshati

poshtë në breg të Drinit”. Kështu vazhduam bisedën sikur kishim harruar përse ishim aty. I shpjegova pastaj se Kom. Ekzekutiv na ka marrë një hyrje me shumë te pallati që kishte ngritë repartit i helikopterëve për efektivin e vet me kontribut vullnetar, sepse nga 15 hyrje duhet te merrte dy, ndërsa ju na keni marrë tre. Dha urdhër, te vinte shefi i urbanistikës dhe i tha direkt në sytë e mi që të kthente apartamentin këtij institucioni ushtarak. Këtu qëndronte aftësia e tij prej kuadri në zgjidhjen e prerë të problemit. U ndamë duke më premtuar se do të vinte në repartin tonë për të bërë një fluturim me helikopter. Dhe vërtetë erdhi tre ditë pas takimit tonë, ku bëri një bisedë me efektivin kuadër, pilot e teknik për punën në dikasterin e tij. Pastaj bëmë një demonstrim me helikopter, por nuk u la të fluturonte, me gjithë dëshirën e tij. U largua duke na zgjidhur edhe një problem tjetër madhore; sjelljen e rrjetit të ujit të pijshëm, në repartin tonë të helikopterëve Farkë.

Ligji i xhunglës në Shqipërinë tonë komuniste, kërkonte të kishte vetëm një kapo, një “unë” dhe çdokush më i fortë, me i dijshtëm, apo më guximtar duhej të eliminohej. Fati i dijes, zotësisë dhe ndershmërisë përbente krim dhe krimi ndëshkohej. Shifrat fiktive në prodhim, në realizime 5-viçarësh, në jetën e “lumtur” te krijuar nga partia, në begatinë e vendit e te tjera, kishin marrë përmasa të mëdha. Të gjithë gënjenin nga lart e deri në bazë, por askush nuk i besonte dhe të gjithë i besonin se duhej besuar, se ndryshe përsëri ndëshkimi ishte prezent. Në raportin që paraqet Manush Myftiu në një plenum të udhëhequr nga kreu i partisë E. Hoxha, flet me shifra fiktive e plot pasaktësi e gënjeshtra në lidhje me sigurimin e bukës në vend dhe marrjen e një rendimenti të lartë në produktet e drithërave në kooperativën e Shëngjergjit të rrethit Tiranës. Ky raportim fiktiv u kundërshtua në vend nga Kryetari i Kom. Ekzekutiv, Ndue Marashi, i cili i thotë se këto shifra nuk janë të sakta dhe se kjo kooperativë nuk siguronte as gjysmën e prodhimit që flitet në raport. M. Myftiu, nuk ishte mësuar ta kundërshtonte njëri dhe me ton i përgjigjet se “duhet të skuqet faqja nga gënjeshtra”, ndërsa Kryetari mbron personalitetin e vet duke i thënë se “unë jam i ndershëm e nuk di te gënjej”. Si mbas të thëna, velem ndërhyrja e E. Hoxhës bëri që situata të qetësohet.

Ky ishte ai inicim në formën e një zjarri të vogël, i cili më vonë do të digjte gjithë shtëpinë dhe fill pas këtij incidenti e kërkon urgjent në takim Enveri, i cili e përgëzon për ndershmërinë e kurajën dhe i thotë se, “... vazhdo kështu, se je në rrugë të drejtë. I kemi gjetur njeriun e duhur Tiranës...”. Por duhet kuptuar se kjo ishte taktika djallëzore e diktatorit, i cili para se të godiste të jepte një “dozë gjumi”, taktikë që e kishte përdorë edhe me të tjerë dhe do ta përdorte deri në fund të jetës se tij. Ishte e vështirë të “hahet” malësori i jonë i ndershëm me një klan jugor tepër dinak dhe të pabesë. Në mbrapa skenë u përgatit një buletin për përdorim të brendshëm në parti, i cili u shpërnda urgjent nëpër të gjitha organizatat e partisë së Tiranës, ku Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të rrethit Tiranë, Ndue Marashi cilësohej si “njeri i drekave e darkave” se “ishte si qehajai i Tiranës e deri imoral”, duke përgatitë terrenin për fundin e tij si drejtues, si politikan e si njeri. Vala e kësaj situatë tepër të tensionuar u pasua nga një tjetër ngjarje e rëndë dhe e jashtëzakonshme që ra direkt mbi shpatullat e Kryetarit. Në kooperativën e Baldush-

kut të Tiranës ngordhën rreth 100 lopë nga helmimi me zhivë dhe menjëherë formulohet akuza tjetër në drejtim të Ndue Marashit si “përgjegjës direkt për punën e grupit armiqësorë”. Sipas hetuesit të çështjes së asaj kohe, Dilaver Bengasi, Manush Muftiu i jep urdhër të arrestohen deri 100 vetë, po unë, thotë ai, arrestova 8 persona e dy me pushkatim. Por e parë nën dritën e fakteve të sotme, kjo ishte thjeshtë një hakmarrje primitive ndaj Ndues dhe kjo ngjarje lidhet direkt me sigurimin e shtetit e klaneve në udhëheqje. U arrit deri atje sa të thuhej se mjelësja e lopëve, Nadire Shima dhe punëtori i stallës Selman Balla, ishin me biografi të keqe e për këtë nuk ishte zhvilluar lufta e klasave nga kuadrot e deri në nomenklaturat e larta të ekzekutivit. Po ku e siguruan zhivën këta fshatarë të mjerë? Për grup armiqësorë bëhej fjalë?. Kush e udhëhiqte këtë organizatë armiqësore?. Me këtë rast u dënuan dhe u pushkatuan disa njerëz të quajtur në atë kohë “me biografi të keqe”, por pa as me të voglin faj dhe që ishin planifikuar të hiqeshin qafe, por kokra ishte tjetërkund, ishte të ai njeri, që siç thoshte ish shoku i ngushtë i Ndues, Fadil Lame se: “Ora e tij punonte në krahun e dashurisë humane”. Pas kësaj ngjarje të Baldushkut fillon lufta e hapur e kastës udhëheqëse kundër Ndues, ku merrnin pjesë më potentët e vendit si E. Hoxha, i cili shprehet se “duhet shikuar puna armiqësore e këtij krijtari”, si dhe M. Shehu, K. Hazbiu, M. Miftiu e te tjerë. Periudhës tepër të rënduar, të vështirë e tepër stresuese që kalonte familja Marashi, i shtohen edhe disa letra anonime të iniciuar nga vetë M. Miftiu, kundër N. Marashit. Kësaj nuk i mungoi edhe kërcënimi direkt që i bën M. Shehu në një darkë për nder të një delegacioni të huaj, ku si protokoll kishte vendin e vet Kryetari i Komitetit Ekzekutiv. M. Shehu troket gotat me të pranishmit dhe kur i vjen radha Ndues, i thotë gjithë kërcenim se “e kemi pak punë me ty”.

Që nga ajo ditë e deri sot kanë kaluar plot 40 vjet, kur 42 vjeçari, njeriu i parimeve njerëzore, personi politiko-drejtues që kishte hyrë kaq thellë në zemrën e popullit, i mungon familjes, i mungon historisë, na mungon në bashkëkohësve të tij e mbi të gjitha mungon e vërteta e ngjarjes.

Vetëvrasje apo vrasje? Kjo vazhdon të jetë dilema që shtojnë për zgjidhje bashkëshortja Françeska tashme e sëmurë, të bijtë, familjarët dhe gjithë opinionin dashamirës i Ndue Marashit. Pas peripecive të internimeve dhe vuajtjeve të pafund për 16 vjet, këto familjarë menduan se nderi i pjesëtarit të familjes tyre do të vihej në vend mbas viteve 90’, por Presidenti i asaj kohe, Berisha, në takimin që i kërkuan njerëzit e afërm të Ndue Marashit, u premtonte atyre për një zbardhje të çështjes dhe me kaq mbeti nën hirin e harresës e diskriminimit, megjithëse kanë shkuar e ardhë disa qeveri deri tani, kjo histori e trishtueshme nuk është zbardhë akoma. “Ne nuk kërkojmë hakmarrje - thotë Franceska, - por duam të dalë e vërteta”.

Vetëvrasja apo vrasja po zhduket dalëngadalë në heshtjen e përjetshme, ku e mori me vete në varr atë ditë dimri të vitit 1975, malësori, njeriu i ndershëm, shembulli i lartë i një kuadri, biri i Dukagjinit, Ndue Marashi.

*Ndoc Selimi
Milano, shkurt 2015*

MËSUESIA QË BERI "HATANË"

FTESË PËR DEBAT PUBLIK

Në emër të një modernizmi dhe një lirie të shfrenuar shkolla është katandisur në shtrat të ngrohtë të duhanit, alkoolit, drogës, seksit dhe injorancës! Kemi përdhosur dhe shpërfytyruar rolin e mësuesit si autoritet i shenjtë i edukimit, duke e kthyer në një spiker robot të gjithfarë tekstesh dhe programesh eksperimentale donkishoteste me fasadë reflektuare didaktike. Kjo liri pa limite që ekziston në shkollat tona prodhon mijëra e mijëra viktima, aq sa kufiri mes shkollës, rrugaçerisë dhe burgut nuk dihet se ku fillon dhe ku mbaron. Unë kam punuar shumë, me shumë pasion e dashuri për mbi 14 vjet në arsim tetëvjeçar dhe te mesëm. Në kohën kur isha unë nxënës, sundonte modeli autoritar i mësuesit, ku një pjesë mësuesish ishin kthyer në autokrat të frikshëm. Sot mbizotëron modeli i mësuesit liberal dhe raportet janë përmbysur në favor adoleshentëve të frikshëm, të cilët dhunojnë sistematikisht mësuesit e tyre, duke i vënë në situata të vështira dhe pa rrugëzgjdhje.

Ajo mësuesja që paska bërë hatanë në Malësinë e Madhe . Hata të cilën nuk do ja uroja as një edukatori të bije në pozita të tilla pasionate, të kushtëzuara as të pa kushtëzuara. Ajo, mësuesja që beri hatanë, ndaj policia menjëherë filloi procedimin penal! Ajo, mësuesja e talentuar e matematikës beri hatanë sa që detyron Ministrën të shpëtojë fytirën "moderne" të shkollës duke e pezulluar menjëherë. Ajo, mësuesja që beri hatanë dhe mediat veprën e saj "vampire" e shitën si lajm i kronikes se zezë. Ajo, mësuesja që beri hatanë, ndaj Krye-komunari i Krahinës thirri urgjentisht një konferencë shtypi për mbrojtjen e te drejtave të fëmijëve të fshatit të tij. Ajo, mësuesja që beri hatanë, ndaj dikush fërkoj duar, shyqyr që do ti zë mostrës së dhunshme vendin. Për ju Zonja Ministre! Për ju koleg gazetar! Për ju prindërit! Mbi të gjitha, për ju shoqërinë, skllavëria e nxënësve ndaj celularit dhe fb, jo vetëm

në shkollë, por dhe brenda orës së mësimit duhet të ishte hata që tu bënte të thërrisnit kushttrim! Ndal vrasjes së mësimit! Pasi celulari është autobombe, vrasje e orës se shenjtë të mësimit!

Zonja Ministre, më e hatashme se gjesti mësueses, është futja e celularit edhe në tetëvjeçare. Pasi, pikërisht nga aty, nga nxënësit minoren të "armatosur" me teknologjinë e kohës është bërë video-skandali e famshëm që pushtoj dhen. Ndonëse jetojmë në mes të një darvinizmi të egër social në emër të një humanizmit të rremë dhe të drejtave false të njeriut, për tu dukur në pamje si shtet modern. Provojmë dhe shesim video të tilla viktimizuse! Për një xhirim amator, kur polici rrahë një hajdut që grabitë varëset në qafat e grave, nenave tona apo kriminel të nderkyer policin e hedhim si letër higjienike në koshin e plehrave dhe kënaqim media për të bërë lajm. Për tu dukur në pamje vend me standarde evropiane shesim video të tilla viktimizuse, ku femra e instruktuar nga dashnori zihet me burrin, i cili del fitues në duelin dhe me pas përfundon në burg për dhunë familje. Në pozitën e asaj mësuese, mund të gjendesha edhe unë nëse do punoja si dikur në profesion tim të parë dhe me te dashur. Në atë pozicion mund të gjendet nesër edhe bashkëshortja ime dhe qindra koleg të saj në Shkodër e gjetkë, të cilët janë edhe prind edhe mësues edhe edukator. Sinqerisht do të tregohesha shumë më i ashpër në se në orën e mësimit do të konstatoja nxënës që shohin në fb gjera pornografike. Kërkoj ndjesë publike në se gjera të tilla nuk ndodhin në klasat tona. Nuk di se çfarë beja nëse shihja nxënësit duke u puthur në ambientet e shkollës, duke pirë duhan në klasë apo t'u gjeja thika dhe doreza. Si oficer i policisë gjyqësore kurrë nuk jam ndier më keq se kur kam arrestuar një nxënës të klasës 10-të me pistoletë, të cilën e kishte përdorur në ambientet e shkollës duke sulmuar

MBLEDHJE E JASHTËZAKONSHME E KRYESISË SË SHOQATËS "ATDHETARE DUKAGJINI"

ME DATËN 12.2.2015 U BË MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KRYESISË SË SHOQATËS "ATDHETARE DUKAGJINI" E CILA MORI NË SHQYRTIM DY PROBLEME KRYESORE:

I-Puna e deri tashme dhe masat që duhet të merren për mbledhjen e fondeve dhe ngritjen e përmendoreve të patriotit Mehmet Shpendi dhe albanologut Martin Camaj. Gjatë diskutimeve doli se është bërë një punë mjaft e mirë për njohjen dhe përhapjen e kësaj nisme. Janë bërë takime dhe janë marrë përsipër detyra nga të gjithë anëtarët e kryesisë, kryesitë e degëve në rrethe të ndryshme, nga familjarë dhe të afërm të heronjve që do të vendosen në qytetin e Shkodrës. Komunikim shumë frutdhënës ka pasur, veçanërisht, me vëllezërit tonë në New York dhe po kështu në Miçigan të SHBA. Grupi që po punon në New York ka bërë një punë shumë të mirë organizative por edhe konkrete në mbledhjen e fondeve. Vetëm ata kanë mbledhur mbi 50% të fondeve. Edhe vëllezërit tonë në Miçigan kanë punuar dhe po vazhdon mbledhja e fondeve. Edhe në Shqipëri është punuar dhe ka filluar mbledhja e fondeve. Në mbledhje u fol për ngritjen më lart të punës në këtë drejtim. Është kënaqësi, u tha në mbledhje, kur shikojmë se skulptori ka filluar punën për të bërë gati e përmendoret për tu derdhur në bronx. Të gjithë anëtarët e kryesisë morën përsipër takim kokë më kokë me intelektual, dashamirës të Dukagjinit dhe dukagjinase, patriot, familjarë dhe të afërm të heronjve dhe përshpejtimin e punës. Gjithashtu u vendos që tu dërgohet një letër miqësore publike shumë intelektualëve, biznesmenëve, familjarëve dhe të afërmeve të heronjve, dashamirësve të Dukagjinit dhe veprës së Mahmet Shpendit dhe Martin Camajt me qëllim që të përfshihen në grumbullimin e fondeve. Në mbledhje doli se kemi raste të pritjes dhe mendimit se kemi kohë, e cila u quajt si një vonës e paarsyeshme por edhe që pengon punën e skulptorit. Kryetari i Shoqatës z. Ndue Sanaj falënderoi me fjalë zemre të gjithë donatorët, por shtroj edhe detyra konkrete për secilin anëtar të kryesisë së shoqatës dhe drejtuesit e degëve të saj.

II-Plotësimin e vendit të Kryeredaktorit të gazetës "Dukagjini", pas dorëheqjes së zotit Lazër Kodra i cila e ka drejtuar për disa vite. U vlerësua puna e tij e mirë dhe ju kërkua që të mbetet një bashkëpunëtor i përhershëm i kësaj gazete. Kryesia e pranoi dorëheqjen e tij. Arsyja e dorëheqjes ishte vetëm për mbingarkesë pune duke qenë se është drejtor në një shkollë të mesme profesionale në qytetin e Shkodrës. Me propozim të lirë nga anëtarët e kryesisë u ra dakord unanimisht që në detyrën e kryeredaktorit të caktohet sekretari i shoqatës Luigj Shyti.

Korrespondenti i gazetës
"DUKAGJINI"

rivalin si Nikë Peta-Palë Golemin. Sikur të isha Ministër nuk do lejoja të punonte kurrë në shkollë atë mësues dhe atë drejtor kur prindi e dërgon vajzën 13 vjeçare në shkollë dhe brenda orarit të mësimit, vajza me shoqe del e shkon në klub nën shoqërinë bandillëve të shkollës dhe atje ish i dashuri i saj 16 vjeçar qet pushkë për "nder" duke plagosë bashkëmohatarin e tij. Shikoni ku kemi përfunduar! 13 vjeçarja të cilën e kam hetuar, deklaronte pa ju dridhur syri, kam pasur marrëdhënie paralele me dy partner. Për analogji, bariu i mirë nuk e le mëshqerën, ftujën as rruxhën pa mbushur tre vite te mbarset. Kurse Mediat tona bëjnë për seksin dhe kontrceptivet për moshat minoren/e. Kjo është liria dekadente e kapi-

talizmit, e këtij oqeani të përbotshëm rrezatues si argjendi të mbushur me peshkaqen, i verbuar dhe i çmendur nga paraja, i droguar dhe infektuar nga Sida e imoralitetit. Plagët e renda të rinisë sotme nuk janë thjeshtë dukuri shqiptare, ato janë pjella e këtij sistemi të ndyrë, por që akoma bota nuk po gjen dot një tjetër më të mirë. Ligësitë e shkollës sonë nuk vijë nga shputa nxituara të një, apo te disa mësuesve konservator të riparueshëm, pasi pjesë edukimit klasik krahas bindjes është edhe detyrimi dhe ndëshkimi. Shkolla nuk është vend minifundesh, dekolte të shkopsitura, pantalona të grisura, bizhush, makijazhesh, apo thonj kthetërues shqipesh. Shkolla është vend edukimi, dije dhe disipline, nëse njeri nga këto element nuk funksionon atëherë i duhet vënë një emër tjetër.

PRELË MILANI,
poet dhe publicist



SHIME DESHPALI, POETI ARBËRESHI ZARËS QË RUAJT GJUHËN DHE TRADITAI

Rreth mesit të shek. XVIII, pikërisht në vitin 1721 nga fshatrat rreth liqenit të Shkodrës, sidomos Ljarje dhe Shestan u shpërngulën rreth 32 familje shqiptare me rreth 270 frymë dhe u vendosën në fshatin Zarë të Dalmacisë. Lëvizja e tyre e padëshiruar, ishte e lidhur me shkaqe historike ku më të mundshmet mund të jenë luftrat e shpeshë, sëmundjet e ndryshme, kërkesa e qeverisë osmane për nizamë, kushtet e papërbalueshme ekonomike, kërkesa e qeverisë osmane për tu asimiluar në fenë myslimane, por edhe pazarllëqet që bënin qeveritarët turq me ata venedikas ose sllavë për interesa të ngushta dhe meskine.

Familjet shqiptare u vendosën në Zarë, qytet kroat që ndodhet në Dalmaci me një histori të lashtë 3 mijë vjeçare që në literaturën historike njihet si qendër e fisit ilir të Liburnëve. Rreth shekullit III pas Krishtit u pushtua nga romakët dhe u njoh me emrin e lashtë Jadera, ndërsa në shekullin VI gjithë krahina bie nën sundimin bizantin. Aty nga shekulli IX nga Azia qendrore në këta rajone vijnë fiset kroate, të cilat u përshtatët shpejt me kushtet natyrore dhe ngritën edhe qytetin e bukur të Zarës, të cilin në vitin 1202 e dogjën dhe e shkatërruan venedikasit. Në shekullin XV, qyteti u administrua nga venedikasit dhe më vonë nga austro-hungarezët e të tjerë, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore vihet nën administrim të qeverisë kroate.

Kolonitë shqiptare në brigjet Dalmate përbëjnë një rast të veçantë të ruajtjes së identitetit arbëror. Tek këta koloni pasqyrohen elemente të veçanta dhe tepër të rralla të identitetit shqiptar. Kolonia e parë që daton në vitin 1721, ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën e familjeve shqiptare që vërshuan në vitet e mëpasme drejt Kroacisë duke i strehuar dhe duke i ndihmuar bashkëkombasit e tyre për të mbijetuar nga përndjekjet e pushtuesve turq ose nga shantazhet e fqinjëve shovinistë sllavë, duke mos harruar asnjëherë origjinën e tyre shqiptare dhe duke mos shkëputur lidhjet me tokën e tyre mëmë. Kjo për faktin se pas shpërnguljes së parë, kemi edhe tri shpërngulje të tjera

masive në vitet 1726, 1727, 1733, ku të gjitha familjet e shpërngulura ishin shqiptarë, ndërsa në vitin 1726, u larguan



nga trojet tona 147 shqiptarë. Duhet theksuar se kolonitë shqiptare të Zarës në Dalmaci i kanë rezistuar rresheve të kohës, nuk janë asimiluar nga fiset sllave, por kanë ruajtur gjuhën, doket, zakonet, emrat, mënyrën e jetesës. Ata e pohojnë kurdoherë prejardhjen e tyre arbërore dhe në përgjithësi flasin shqip, sidomos brenda familjes duke synuar të ruajnë dhe transmetojnë brez pas brezi gjuhën e tokës amë.

Veç gjuhës, arbnesi i Zarës ka ruajtur edhe emrat e mbiemrat shqiptarë. Kështu, në zarë takojmë emra të tillë si Gjon, Gjergji, Mark, Pjetër, Teutë, ndërsa për mbiemrat ata kanë ruajtur tradicionalisht mbiemrat e vendlindjes së tyre si Kamsi, Gjergji, Deshpali, Petani, Çoba, Nikpali, Luka, Gjini, Gjoni, Vuka, Nika e të tjerë, por kanë ruajtur edhe shumë toponime me origjinë shqipe. Kështu, në Zarë takon emra vendesh si: Fusha e varreve, Fusha e Arbneshit, Gropa Shkamit, Kisha, Kullat e të tjerë, duke ruajtur kështu emërtime të pastra shqipe. Arbnesët e Zarës janë njerëz me kulture, traditë dhe shije.

Shkolla shqipe në Arbnesët e Zarës u hap në vitin 1901 dhe qëndroi e hapur për 17 vjet deri më 1918. Interesant është fakti se mësuesit e parë të saj kanë qenë prelatët e nderuar të fesë katolike si atë Shtjefën Gjeçovi, atë Pashka Bardhi, prof. Anton Paluca, prof. Pal Gjergji. Në fund të shekullit XIX edhe arbnesët e Zarës

dhanë një kontribut të shquar në lëvizjen për çlirim kombëtar. Idetë e tyre patriotike intelektualët arbnesë i publikuan

përmes gazetës së tyre "Zani i Shqiptarit" që u botua në disa numra në Zarë.

Katundi Arbnesi i Zarës në Dalmaci ishte një vend i bukur, plot jetë dhe dritë, ndërtaur nga duar mjeshtresh me origjinë shqiptare. Të tillë ishin edhe arbnesët e Zarës, të cilët S. Buzolici i përshkruan "... janë njerëz me faqe të kuqe që pëlhasin nga shëndeti. Shikimin e kane të rreptë dhe plot zjarr, shtatin e mesëm por të bukur. Për nga karakteri janë hijerëndë sa dhe të njerëzishëm. Fjalën e kanë në majë të gjuhës shpërthejnë si orteku, por edhe qetësohen shpejt, zërin e kanë melodik dhe këndojnë shumë bukur...".

Ndërsa intelektual i njohur dhe poeti i shquar J. Rela thekson: "... Në fillim shtëpitë i kishin përdhese, më vonë ndërtaur kulla të rrethuara me mure të lartë dhe me kopshte me lule përreth. Këta janë pa mëdyshje, rrjedhim i zakoneve nga viset e tyre të vjetra. Duke qenë një fis me tradita kulturore dhe atdhetare, nga arbnesët e Zarës dolën edhe figura të shquara që përfaqësuan denjësit kulturën, artin dhe letërsinë arbneshe.

Të tillë mund të përmendim Shime Deshpalin, Aleksandër Stipçeviç, Josip Rela, Zef Duka, Pal Gjergji e të tjerë. Kanë qenë të paktë ata studiues apo biografë që jan marrë me këta figura të shquara, prandaj mbetën gati të panjohura nga sfera të ndryshme të kulturës në vendin tonë. Ata meritojnë një vend

nderi në letërsinë tonë, krahas figurave të shquara të letërsisë arbëreshe si Zef Serembe, Jeronim De Rada, Gavril Dara, Jul Veribaba, Varea Ujka, Saladore Kuazimodo e të tjerë. Një nga më të shquarit poet, shkrimtar, muzikant dhe këngëtar ishte edhe Shime Deshpali, mësuesi patriot i Zarës që lindi dhe vdiq shqiptar. Sot në Kroaci jetojnë rreth 19 mijë shqiptarë që pushteti kroat ka synuar ti asimilojë, por ata kanë mbajtur gjithmonë traditën dhe karakterin e tyre shqiptar.

PËR TOKËN E SHQIPEVE

Shime Deshpali, poeti i shquar i arbëreshëve të Zarës në Dalmaci qe një nga përfaqësuesit më të denjë të kulturës dhe të letërsisë shqipe. Ai lindi në vitin 1897 në Zarë, në një familje patriotike të ardhur nga Shestani në vitin 1721. Familja e tij u vendos në Arbnes të Zarës dhe u muar kryesisht me bujqësi dhe blegtori për të siguruar bukën e gojës larg atdheut të të parëve. Gjendja e vështirë ekonomike, varfëria dhe mundimi, jeta e vështirë do të linte gjurmë të thella tek djaloshti i vogël.

Rreth vitit 1903, nis mësimit në shkollën fillore të fshatit me mësues Atë Pashka Bardhin përmes të cilit u pais me kulturë të gjërë dhe me dashuri të pakufishme për dheun e të parëve. Pasi përfundoi shkollën fillore, vijoi mësimit në shkollën normale në zarë ku u përgatit dhe mori njohuri në fushën e edukimit. Studimet e larta i vijoi në Zagreb në fushën e muzikës, pasioni për të cilën i kishte lindur që në moshë të re.

Për shumë vite me radhë punoi si mësues i lëndës së muzikës në Arbnes të Zarës, ku veç edukimit muzikor dhe dirigjimit i praktikonte nxënësit edhe në fushën e këngës, sidomos atë patriotike. Gjatë kësaj periudhe hartoi shumë këngë kryesisht për atdheun e tij, për figurat e shquara, për fshatin e tij Arbnes, madje krijoi edhe një opera me titull "Vana" me motive patriotike. Kjo krijimtari e bëri Shime Deshpalin një intelektual dhe krijues të njohur në koloninë arbneshe të zarës dhe një mësues patriot të nderuar.

Shpesh kur bisedonte me prindërit e tij rreth oxhakut në

netët e gjata të dimrit, tema qëndrore ishte ajo e dashurisë për atdheun. Gjyshi i tij i tregonte histori dhe ngjarje për vende dhe trima nga vendlindja duke i edukuar Shime Deshpalit ndjenjën e patriotizmit dhe dashurinë për atdheun.

Kjo temë do të sundonte edhe krijimtarinë e tij të mëvonshme. Këtë e vërteton edhe fakti që së bashku me shkrimtarin e shquar Josip Rela, është ndër të parët qe merret me veprimtari artistike dhe në vitin 1921 patë vënë në skenë dhe shfaqur pjesën dramatike "Lundërza e Jozhës", qe përben tekstin e parë serioz të arbreshëve të Zarës si dhe pati formuar shoqërinë kulturore dhe artistike "Arbnesi" në Zarë, ku hartoi një program për edukimin patriotik të të rinjve me qëllim që, siç e pati thënë edhe ai vetë: "... këtë e kam ba me qëllim që të ndihet Arbnesi, Ti kallxoj botës shpirtin e katundit tem, virtytet e vllazëne të mij, të merret vesh se na jena arbën...".

E në kuadër të kësaj shoqërie, Shime Deshpali si një atdhetar i vërtetë pati organizuar mjaft aktivitete kulturore dhe artistike, takime, vizita, koncerte në funksion të ruajtjes së gjuhës, historisë, traditave, zakoneve, veshjeve dhe cilësive të tjera morale të arbnesëve. Ka nisur të botojë krijimet e para në revistën "Jeta e re" qe në vitin 1953, pastaj botoi edhe në revistat "Lenës" dhe "Romane".

Krijimtaria letrare e Shime Deshpalit vijon me librin me tregime "Tregime arbno", botuar në vitin 1966 nga "Jeta e re" në Kosovë. Në këta tregime autori synon lartësimin e virtyteve morale dhe patriotike të arbnesëve. Tregimet e këtij vëllimi janë pasqyrë e jetës dhe veprimtarisë të arbnesëve, e karakterit burror dhe mjedisve fshatare ku gjallen puna dhe jeta. Përshkruan mjedis, tradita, zakone, tipa dhe portrete të arbnesëve duke synuar ti afrojë sa më shumë me shqiptarët e sotëm.

Kudo ndjehet vuajtja, mundimi, jeta e vështirë që shqiptarët të gjojnë nuk iu nda as në mërgim. Në një tregim të titulluar "Fyerje", shkëputur nga "Tregimet arbneshe", botuar

vijon në faqen 8

10 PERSONAZHET SHKODRANË TË VITIT 2014

Për të dytin vit radhazi Agjensia e Spektakleve "Buna 1" me producent dhe president, Arben Mazi, me datën 25 janar 2015, organizoi në qytetin e Shkodrës një mbrëmje gala në Teatrin "Migjeni", për të nderuar personazhet më të spikatur publikë të këtij qyteti, për kontributin e tyre në vite në fusha të ndryshme sociale, kulturore dhe artistike të jetës.

Për disa javë me radhë ka qenë publiku që ka votuar në adresën e internetit të kësaj agjensie për figurat më të shquara si: shkrimtari më i mirë i vitit, piktori, aktori, sportisti, biznesmeni, politikani e te tjere. Risia e këtij edicioni të dytë të "BEST 10 NORTH" 2014, filloi që në hyrje të Teatrit "Migjeni" që duke u duartrokitur nga të pranishmit, u bë parakalimi në tapetin e kuq i personazheve të kësaj mbrëmje.

Salla e Teatrit "Migjeni" me një publik të zgjedhur u bë pjesë e kësaj mbrëmje gala të ndarjes së çmimeve, të organizuar jo si një ceremoni solemne, por si një spektakël që do ta bënte atë të këndshëm e impacionues.

Spektakli u hap me mrekullinë e tingujve që solli performanca e violinçelistit të njohur Iljard Shaba dhe që u prit me duartrokitje nga të pranishmit në sallë.

Sipari i hapur prezantoi para publikut një dekor emocionues të realizuar në mënyrë artistike dhe funksionale nga skenografi i Teatrit "Migjeni" Hysni Halili, si dhe grafika nga Valmir Hysa. Në këtë platformë magjike, po aq magjik u shfaqën para publikut edhe prezantuesit e kësaj mbrëmje Siçiljana Mazi dhe Simon Shkreli, që vendosën që në prezantim një urë admirimi me publikun për personazhet që do të ngjiteshin në këtë skenë, për të marrë "shpërblimin" e mirënjohjes së bashkëqytetarëve, për veprimtarinë e tyre në shërbim të qytetit dhe më gjërë.

Së pari u përkujtuan personalitetet që një vit më parë u vlersuan në Best 10 North 1, por që nuk jetojnë fizikisht. Vepra dhe kontributi i tyre si artistë nuk vdesin kurrë.

Kështu u përkujtuan kompozitori Mark Kaftalli, studiuesi Mentor Quku dhe shkrimtari Skënder Drini, figura të mëdha të artit dhe kulturës jo vetëm të Shkodrës, por të mbarë kombit shqiptar.


Në këtë atmosferë të ngrohtë që mbizotëronte në këtë sallë të tejmbushur, filloi sipas programit edhe "procedura" e dhënies së çmimeve për 10 personalitetet më të shquar të vitit 2014, të cilët u ngjitën në skenë mes duartrokitjeve dhe emocioneve, duke shprehur mirënjohjen e tyre për vlerësimin që iu bënte qyteti dhe komuniteti shkodran.

Kështu me radhë u ngjitën në skenë më të mirët e vitit, duke filluar nga shkrimtari Skënder Temali dhe duke vazhduar me piktorin Muhamet Ganjolla, skulptorin Skënder Kraja, aktorin dhe regjisorin Bruno Shllaku, aktorin e humorit Besnik Çinari, politikanin Mark Frroku, kryekomunarin e Bushatit Zef Hila, tranierin e boksit Zef Gjoni, boksierin kampion Kristian Demaj dhe biznesmenen Keti Bazh-



dari.

Në të njëjtën kohë, vlerat e këtyre emocioneve i shtonte njëkohësisht edhe pjesëmarrja në këtë ceremoni e shumë personaliteteve që dorëzonin këto çmime, por që edhe vetë janë pjesë aktive e jetës sociale, kulturore, artistike e sportive e qytetit.



Skender Temali, poet



Bruno Shllaku

Deputeti Agron Çela, prefekti Paulin Radovani, kryetari i këshillit të qarkut Maxhit Cungu, drejtoresha e arsimit Afërdita Hakaj, miku i pëhershëm i artistëve dhe i sportistëve shkodranë Gjergj Liqejza e shumë të tjerë, shprehën konsideratat e tyre jo vetëm për fituesit, por edhe për punën e lavdërueshme të Agjensisë



Besnik Çinari



Mark Frroku

"Buna 1" për evidentimin dhe promovimin e tyre.

Për ta mbajtur të ndezur atmosferën e kësaj nate dhe për t'i dhënë larmi e gjallëri këtij spektakli, ishin të ftuar edhe

këngëtarët Eduart Jubani, Myfarete Laze, Jolanda Gjeluçi dhe talentet më të rinj të humorit Erol Rakic dhe Lusinda Bregu, të cilët me performancat e tyre, dialoguan me të ftuarit, e "zhveshen" atë nga kornizat ceremoniale zyrtare.

Agjensia "Buna 1" nuk u mjaftua me këto vlersime, por thirri para publikut shkodran personalitete të tjera të shquara, që kontributin e tyre nuk e shtrinë në një apo dy vite, por në një karrierë të gjatë në shërbim të qytetit dhe më gjërë.

Kompozitori i shquar prof. Zef Çoba dhe drejtuesi i palodhur i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, dirigjenti Kujtim Alia u ngjitën në skenë duke marrë bashkë me duartrokitjet edhe mirënjohjen për punën e palodhur dhe pasionante si artistë dhe profesionistë të vërtetë. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Një artist i shpreh mirënjohjen një kolegu të tij. Prof. Zef Çobës ia dorëzoi këtë çmim mirënjohjeje poeti dhe shkrimtari prof. Alfred Çapaliku, ndërsa Kujtim Alisë, ia dorëzoi shkrimtari dhe dramaturgu i shquar prof. Fadil Kraja.

I papërtuari, i kudo ndodhuri, miku dhe dashamirësi i gjithë shkodranëve dr. Zyhdi Çoba nuk pati aspak emocion kur u ngjit në skenë për të marrë çmimin e karrierës, pasi siç u shpreh ai, karriera ime si mjek është e barasvlerëshme me jetën time, pasi gjithë këtë jetë e kam kaluar mes shkodranëve të mi në të gjitha lagjet, rrugët dhe rrugicat e qytetit ku kam lindur dhe ku jam rritur. Ndjehem krenar që jam edhe mjeku dhe fansi i të gjithë sportistëve shkodranë, veçanërisht i ekipit të futbollit "Vllaznia".

Një çmim special iu dha këtë natë shkodranit (dukagjinasi) më të suksesshëm z. Ndue Ftoni, i cili jeton në Amerikë dhe me aktivitetin e tij në Miçigan ka mbështetur shumë artin shqiptar dhe artistët shkodranë.

Agjensia e spektakleve "Buna 1" nuk e kishte harruar edhe detyrën e saj për të vlerësuar edhe talente të rinj të Shkodrës, ku kishte përzgjedhur vajzën e talentuar, shkrimtaren e re, Amina Meshnuni

Në këtë mbrëmje ishin të pranishëm drejtues të institucioneve vendore, deputet, njerëz të shquar të artit, kulturës, sportit, biznesit e te tjere. të cilët e quajtën veten të privilegjuar që patën nderin t'u dorëzonin çmimet 10 personazheve më të shquar të vitit, që këtë natë ishin nominuar si më të mirët.

Gjatë këtij spektakli pati edhe përshëndetje nga personazhet e vlerësuar si dhe nga personalitete të ftuar.

Përshëndetja e shkrimtarit Skënder Temali në momentin e marrjes së çmimit për shkrimtarin më të mirë të Veriut gjatë vitit 2014, erdhi në formën e një falenderimi.

"Falnderoi prindërit, gruan, djalin e vajzën, vëllain e dy motrat, që kush më shumë e kush më pak, gjatë 50 viteve krijimtari më kanë çliruar nga shumë obligime familjare, që t'i përkushtohem sa më shumë letërsisë dhe të arrij të botoj

15 vëllime me poezi, tregime, novela e dy romane”.

Aktori i mirënjohur i estradës profesionale e Teatrit “Migjeni” Besnik Çinari me humorin që e karakterizon u shpreh: “Me thanë të drejten nuk pata qejf të vlersohem me çmimin e parë, duke pasë para syshë se tre personalitete nga edicioni tjetër që kanë zënë vendin e parë kanë vdekur. Gjithsesi siç thonë shkodrënët “Fjala mort nuk ban”.

Unë kam 40 vjet që merrem me këtë punë, 33 vjet kam si profesionist. Jo gjithmonë kemi qenë mirë, jo gjithmonë iu kemi bërë me qeshë, por kultura juaj ka arritur deri aty ku na keni duartrokatur edhe më tepër. Më vjen mirë që organizohen të tilla spektakle pasi janë të rralla në Shqipëri. Nuk i organizon kush, ndoshta vetëm Tirana, por kjo tregon shkallën tonë të kulturës dhe të artit në qytetin tonë, ndaj ta kemi për nder ku jetojmë dhe t’i dalim zot Shkodrës në të gjitha fushat e jetës”.

Seladin Gjeloshi, biznesmen nga Ulqini, i ftuar në këtë mbrëmje u shpreh: “Kam nderin e veçantë dhe privilegjin e madh që sonte ndodhem këtu me publikun e mrekullueshëm shkodran. Teatri “Migjeni” është i Shkodrës, por edhe ne ulqinakët, anamalsit dhe krajanët e ndjejmë veten si pjesë e këtij tempulli të kulturës kombëtare. Të gjithë e dimë se humoristët kanë dhënë një kontribut të madh, por në veçanti më vjen mirë që Agjensia e spektakleve “Buna 1” nderon me çmim humoristin më të mirë të vitit të madhin Besnik Çinari”.

Prof. Zef Çoba, pasi falënderoi organizatorët e këtij spektakli, tha se këtë vlerësim ia dedikoj njeriut më të shtrenjtë të jetës, nënës së tij, e cila ishte ndarë nga jeta para pak ditësh. Në qoftë se pak nga atributet që janë thënë këto ditë për mua janë të vërteta, ju them sinqerisht që ato nuk më përkasin vetëm mua, ato i përkasin vetë muzikës, artit muzikor dhe forcës së këtij arti. Besoj se me forcën e këtij arti të gjithë mund ta bëjmë edhe më të bukur jeten. Ky është përkushtimi im, prandaj ia kushtoj forcës së artit muzikor për çka kam mundur të bëj.

Përmes emocioneve të papërshkrueshara e mori fjalën prof. Fadil Kraja, i cili me mençurinë dhe mjeshtërinë e fjalës së tij tha: “Në Shkodër është një shprehje: “Një njeri që bën emër e ka kaluar urën e Bahçallekut”. Njeriu të cilit i japim këtë çmim sot është shoku im, miku im, miku i gjithë Shkodrës, por në mënyrë të veçantë, miku i gjithë fëmijëve Kujtim Alia. Gjithashtu ai ka një meritë të veçantë për rikthimin e vlerave të jetës kulturore artistike të qytetit, disa prej të cilave gati ishin harruar. Në festivalin ndërkombëtar në Itali për bandat muzikore, banda e Shkodrës e drejtuar nga mjeshtri Kujtim Alia, mori çmimin e parë si banda më e mirë në Europë dhe këtë çmim ia dha Presidenti i Italisë z. Napolitano.

Shkodra ka pasur shumë aktivitete kombëtare që na i kanë marrë, vetëm një s’kanë mundur ta marrin, festivalin mbarëkombëtar të këngës për fëmijë dhe kjo për meritë të Kujtim Alisë. Didakt i shkëlqyer, muzikant i shkëlqyer, dirigjent i shkëlqyer. Faleminderit Kujtim Alia dhe të pastë Shkodra”.

Fadil Kraja u shpreh me shumë konsid-



Zef Gjoni



Keti Bazhdari



Kujtim Alija



Zef Çoba



Ndue Ftoni



eratë edhe për shkodrënanin e suksesshëm me banim në Amerikë z.Ndue Ftoni, për të cilin tha, se është një ndër biznesmenët më të fuqishëm në Miçigan, por mbi të gjitha me një stacion televiziv shqiptar, ku promovohen vlerat e kombit tonë, duke u bërë kështu një ambasador i vërtetë.

Unë mund ta quaj atë mecenat, sepse i ndihmon të gjithë artistët në SHBA. Unë mund ta quaj atë një njeri që ndihmon Shkodrën, sepse vjet organizoi për të paren herë dhe do ta bëjë të përvitshme “Nata Shkodrane”, me humor dhe muzikë nga Shkodra. Vjet në nëntor u ftua humoristi i madh shkodran Besnik Çinari dhe të gjithë këngëtarët në SHBA. Sivjet dhe për çdo vit ai do ta bëjë në muajin maj dhe do ta quaj përsëri “Nata Shkodrane” dhe pjesëmarrja siç ishte vjet prej 1000 vetë, do të jetë përsëri edhe në vitet e ardhshme.

Në fjalën e tij shumë modeste z. Kujtim Alia tha, se kjo skenë është e shenjtë dhe unë ndjehem shumë mirë, por gjithmonë shumë i emocionuar, si shumë vite më parë, kur në vitin ‘73 luaja me violinën e dytë këtu, me një pedagoge që më ka bërë muzikant, Merita Hoti, të cilën e përshëndes nga kjo skenë. Në këtë skenë ndihem shumë mirë. Ne jemi qytet që prodhojmë dhe me kontributin e jashtëzakonshëm të profesor Fadil Krajës si një shtyllë shumë e fortë e këtij teatri, duke i kushtuar një jetë të tërë kësaj skene, ka qenë vazhdimisht në nivelin e duhur.

Ky organizim i madh nuk do të bëhej i mundur pa ndihmën e Bashkisë së Shkodrës me kryetar z. Lorenc Luka, të cilin e falënderuan për kontributin dhe kujdesin e dhënë, si dhe drejtorin e teatrit “Migjeni” z. Edmond Angoni me stafin e tij, për bashkëpunimin dhe krijimin e kushteve që do të garantonte suksesin e kësaj mbrëmje.

Gjithë ky aktivitet u sensibilizua rreth një muaj më parë kësaj nate nga televizionet lokale, duke filluar nga TV 1 Channel, Antena Nord, TV Rozafa, Star Plus dhe TV Kopluku, të cilët i kanë bërë publicitetet këtyre personaliteteve.

Suksesi i kësaj mbrëmje gala që ka jehonë edhe sot e kësaj dite meriton edhe

lavdërimet e përkrahësve dhe sponsorëve, dashamirës të mbarëvajtjes së jetës social kulturore të qytetit, ku duhet të veçojmë falënderimet që u bënë për Grand Hotel Europa, Beauty center star, pronarin e restorant “Kurora e Artë”,



Zyhd Çoba

z.Artur Lushi si dhe SHRSF “Mega Security” e te tjere.

Qershia përmbi tortë ishte mbyllja e spektaklit, kur në skenë doli për të përshëndetur të ftuarit, zëri i mrekullueshëm i këngëtares së madhe Myfarete Laze, e cila para se të këndonte këngët “Sagapo”, “Pragu i vegjëlisë” dhe një “Jare shkodrane” tha: “Çdo skenë ka emocionet e veta, por skena shkodrane gjithmonë mbetet emocion i pa harruar”.

Spektakle të tilla nuk mund të organizohen pa praninë e kësaj pasurie të madhe që shoqëron evente të tilla. Kënga e fundit “Jare shkodrane” ndoshta ishte dhe urimi “natën e mirë”, që ata i dhuruan spektatorëve në mënyrë melodioze, për t’i kujtuar se në këtë skenë, nuk do të mungojnë kurrë aktivitete të tilla, që shkodrënanët i kanë aq shumë për zemër.

Agjensia e spektakleve “Buna 1” mbyll kështu një edicion tjetër të suksesshëm të “BEST 10 NORTH”, duke premtuar që vit pas viti të sjell të tjera risi dhe surpriza.

Pergatite
Ramazan ÇEKA,
Janar 2015

GIAKU SELACËVE DO TË NDRIDHËN DËR SHEKUL..



nga Kadri Ujkaj, studiuues

Kur njihesh me librin "Ahmet Selaci-komandant i divizioni "Ibri" i ushtrisë nacionaldemokrate të "Besës kombëtare" i autorit kosovar Asllan Istrefi, i cili hapet me thënien e poetit tonë të shquar, Dritëro Agollit "Nderi i Kombit": "Në sofrën e shtruar të historisë presin të marrin lugë të gjithë. /Vështronë thelat dhe duan të hanë kurrnacë, grykës, bataçinjë, pelivanë. / Po historia u jep nga një kafe në këmbë dhe thotë e përmbajtur diçka nëpër dhembë / "Na falni, se presim në sofër të vijnë ata që bëjnë vërtetë historinë!"; thënie që vjen si okelio e këtij libri, interesant për nga mesazhi që sjell në konfirmim të një kontributi historik, të shkëlqyer si ai i selacëve të Shalës së Bajgorës-Mitrovicë, bindesh se fisi i Islamëve qe njëri nga fiset më të përkushtuar ndaj çështjes sonë kombëtare duke sakrifikuar gjithçka në emër të zgjidhjes së saj me dinjitet. Duke shfletuar faqet e këtij libri kushtuar jetës së lavdishme të 4 brezëve të Islamëve të Selacit, ndjen brenda vetes stuhinë e shpirtit të një populli të martirizuar, që nuk guxonte të gëzonte as të drejtat më elementare në pjesën e vet të diellit, sikur skllavërohej , apo mund të vritej në format më makabre, nën pushtetin monarkik , apo sllavokomunist jugosllav deri në nivelet më poshtëruese të skllavërimit mesjetar gjatë një shekulli të tërë.

Përmes këtij libri autori arrin të plotësojë, me dinjitet studiuesi , atë faqe të diskutueshme të historisë sonë kombëtare, ndryshe të nacionalizmit shqiptar, i inicuar me lëvizjet kaçake në Kosovë apo çetat patriotike në Shqipëri, deri në struktura ushtarake, nga më kompaktet , në kuadrin e Lëvizjes së Rezistencës, siç qe edhe divizioni "Ibri" i ushtrisë nacionaldemokratike të "Besës kombëtare" me komandant Ahmet Selacin. Në këtë vështrim, me shumë të drejtë, mund pohojmë se Asllan Istrefi, ish-ushtari i UÇK-ës së lavdishme, na e sjell në vëmendje dhe evidentim, si një vlerë kombëtare e shtuar, ndryshe si një monument i vërtetë lirie, i ndritur, jo vetëm për Ahmet Selacin, por dhe për gjithë gjakun e selacëve, sidomos kushërinjtë e tij, krahas Boletinëve, me të cilët gjithmonë u gjendën bashkë, përballë rrezikut , në emër të jetës së Selacit, Mitrovicës dhe Kosovës së lirë sa nga pushtuesi osman, sa nga thundra çetnike serbe dhe ajo sllavokomuniste .

A nuk do të ishin familjet më të njohura që ia shtuan nderin dhe namnin Selacit, Shalës së Bajgorës, Kosovës skaj më skaj dhe trojeve shqiptare, që nga Dur-

rësi e deri në Mërdar, familjet e Ahmet, Mehmet, Rizah, Ajet dhe Imer Selacit?!?. Kjo, aspak rastësisht: "Burrat e Selacit që nga viti 1455, kur dihet për të historikisht dhe deri në shekullin XX ishin ballorë në luftën e shenjtë për të mbrojtur veten dhe trojet stërgjyshore. Selac ishte dhe mbeti fidanishte e trimave që luajtën çarkun e pushkës në të gjitha periudhat historike, kur atdheu ishte në rrezik", - nënvizon autori i librit, zoti Istrefi. A nuk qe kulla e Mahmut e Rexhep Selacit, po aq Kulla e Boletinëve, siç ishte Kulla e Boletinëve po aq edhe kulla e Mahmut dhe Rexhep Selacit , dy vatra të përherëshme të rigonicionit për të mbrojtur deri në pikën e fundit të gjakut gjeografikë e trojeve shqiptare, sa herë që ato sulmoheshin nga taborret turke? Dhe po në të njëjtën kullë tri dekada më vonë Ahmeti, Mehmeti, Ajeti dhe Rezahu do të hartonin të njëjtat rigonicione luftarake, si kundërpërgjigje, deri me jetë, ndaj shkajut të pabesë.

Kurt Selaci, daja i Azem Bejtës, do të nderohej si komitë me famë i Lëvizjes Kaçake dhe po ashtu si përkrahës i Komitetit Kombëtar për Çlirimin e Kosovës. A mund të harrohen komitët tjerë, trima si: Naf, Ahmet e Isuf Selaci, të shpërngulur nga Samadrxha në Fier të Shqipërisë, Zukë, Halil, Rrahman e Shaban Selaci, kaçakë të njohur në rrethin e Vushtrisë? Emrat e trimave selacas si: Feriz Selmani, Qazim Zejnullahu , Sali Smajli dhe Fazli Behrami do t' i gjejmë në regjistrat sllavokomunist për likuidim fizik të vitit 1946. Ndërkaq Ahmet Selaci, Imer Selaci, Mehmet Selaci, Rizah Selaci dhe Ajet Selaci ishin të planifikuar të likuidohen, t'u grabitej prona dhe t'u shfaroseshin familjet shkruan me shumë dhimbje dhe admirim autori.

Po kështu Mahmut dhe Rexhep Selacin, të regjistruar si kaçakë në regjistrat e komunës së Buçanit dhe Soçanicës do t' i njohim edhe si shoqërues të Isa Boletinit, në ditën e Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, sikurse do të jenë në rrethin e tij të ngushtë edhe në Gardën Kombëtare. Gjithmonë pranë Boletinit deri ditën e fundit të jetës, ku vriten nga çetnikët malazezë në vitin 1916, ashtu si Sejdi Selaci dhe Isa Boletini do të plagoseshin, krahu njëri-tjetrit, në mbrojtjen e Kullës së Boletinëve.

Kur regjimi gjakatar sllavokomunist i vlerësohej si njerëz të egjër dhe pa dinjitet civil kosovarët, ishte shpirti human, orientimi civil, fryma e dashurisë për vendin dhe njerëzit, kultura civile, që do të afirmonin selacasit si dashnorë me dinjitet civil të jetës. Ishte shembulli i shkëlqyer i solidaritetit total , ai që do të shquante autoritetin dhe veprën e tribunit popullor Ahmet Selacit si kryetar i komunës së Shalës së Bajgorës.

Gjithherë, i rrethuar nga kujdesi dhe mbështetja e familjes dhe e gjakut të tij, kushërinjëve: Mahmutit, Rexhepit, Rezahut, Imerit, Ajetit, trima dhe fisnik brilantë, solidarizues të motivuar prej shembullit të shkëlqyer të tij do të ushqenin tek Ahmet Selaci patriotizmin e pashoq, zhvillimin me shumë përgjegjësi të obligimeve institucionale dhe inspirimet nga më fisnike, në emër të përparim-

it të jetës së selacasve, të shaljanëve, të mbarë Kosovës dhe Shqipërisë, që i deshi aq shumë. Sentencën e kësaj sakrifice solemne, e këtij impenjimi maksimal, në përmasa të jashtëzakonshme, e shpreh me gjuhën e shpirtit 85 vjeçarja Nuriye Sadiku, ish-gruaja e dytë e Ahmetit: "Eh, kemi parë kiametin me sy. Serbët kurrë s'na lanë t' i çelim sytë. Nuk ua ditëm lezetin as dasmave e lindjeve, por as lotit e dhimbjeve". Nëse në rastin kosovar personalitete të nacionalizmit si Ahmet Selaci, Imer Selaci, Mahmut dhe Rizah Selaci ofrohen si figura dinjitoze, të kompletuara , që me një qëndresë historike sa në zhvillimin e përgjegjësive në frymën e atdhetarizmit në çdo cep të Kosovës, filluar nga Trepça, e pasurive nëntokësore, po aq edhe laboratorit makabër, ku u manifestua ndaj shqiptarëve gjithë barabaria serbo-kroato-sllavene dhe sllavokomuniste gjatë mbi një shekulli, sikur edhe rezistenca e matur, protestat dinjitoze të mirëorganizuar nga kombinimi i shkëlqyer i veprimtimit civil, sindikalisto-politik, në emër të Çështjes Kombëtare nga breznit kosovarësh, për hir të së vërtetës historike duhet pohuar që nacionalizmi shqiptar , edhe pse krejt i ndryshëm nga ai evropian, nuk i shpëtoi dot strategjisë mashtruese të nazifashizmit , ndryshe kolaboracionizmit tragjik, duke pranuar bashkëpunimin me pushtuesin nazifashist në emër të pushtetit vetiak të ditës, apo atij partiak, të së nesërme.

Madje, duke mos pranuar të rrjeshtohet me dinjitet, në koalicionin progresist botëror, jo pse e kërkonte Kominterni, po, sepse e kërkoi shtetet më demokratike të globit si: SHBA dhe Britani e Madhe etj. të cilat kurrsesi nuk pranonin kufinj të kombëtarë, që ofronte nazifashizmi, ata i lejuan vetes edhe akte si Masakra e 4 Shkurtit 1944, në Tiranë, si suport i okupatorit nazifashist, çka sot dëshmohej qartë në arkivat gjermane (AQFA, Fondi : Komanda gjermane, viti 1944, D. 2, Fq.115) Ndërsa duke u arratisur nga Shqipëria së bashku me pushtuesit e mundur me Çlirimin e vendit, ata morën mbi vete përgjegjësinë historike të lënies së gjithë pushtetit politik PKSH, ndryshe përgjegjësinë e vendosjes së modelit famëkeq të komunizmit rus, në Shqipërinë e raskapitur nga lufta, për afro gjysmë shekulli, shprehet nipi i A. Frashërit, akademiku shqiptar, historiani i shquar, Prof. Dr. Kristo Frashëri "Nderi i kombit" (Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe Themelimit të PKSH-ës", fq.273)

Të nderuar vellezër dhe motra të Selacit, të Mitrovicës dhe mbarë Kosovës!

Duke lexuar gjithë kursin çnjerëzor serbosllav, monarkik apo sllavokomunist , gjatë më shumë se një shekulli, mjafton t' i referohesh vetëm tri prej masakrave nga më të përbindshmet si : Masakra 7 ditore e 11 prillit 1941 nga dora gjakatare e Voja Kaliçaninit, ajo e Bihorit, më 5-6 janar 1943, sikurse edhe ajo e Tivarit, mars 1945, vepër e Millovan Gjilasit, sipas Dr. Hakif Bajramit, ("Mos ia kthe pushkën vedit dhe kombit tënd, o Uran Butka", gaz. "Telegraf", më 15.04.2013) që të bindesh, se pse nacionalistët në Kosovë

"kishin të drejtë" që t' i prisnin si shpëtimtarë pushtuesit nazistë në prill 1941.

Më falni , të citoj dy nga këto dëshmi historike, krahas të vërtetës kriminale për Masakrën e Tivarit, tri nga aktet faktografikë, me interes studimi, nga më dinjitozët, si rishikim dhe pasurim i mëtejshëm i historisë sonë kombëtare, në faqet e librit në fjalë. Citoj:

"Lufta e prillit 1941 nxorri në shesh tërë pezmin e serbëve ndaj shqiptarëve. Në Mitrovicë mbretëronte kaosi i vërtetë. Serbët i vrisnin kudo që i hasnin shqiptarët. Më 11 prill 1941 u vra edhe deputeti i dikurshëm, Sherif Voca. Më 11 prill Voja Kaliçanini kishte urdhëruar të vriten shqiptarët prej moshës 17-70 vjeç. Si i nxori nga kazemat, të gjithë shqiptarët i shpuri në breg të lumit Stinica dhe i pushkatoi. Masakrimi i popullatës shqiptare ndodhi në të gjitha qendrat e Kosovës dhe zgjati 7 ditë".

"Njëra ndër masakrat më të trishtueshme ishte Masakra e Bihorit më 5-6 janar 1943. Më shumë se 4000 çetnikë, të prirë ose të urdhëruar prej Vojvodës Pavle Gjurishiqit dogjën 1763 shtëpi, vranë 590 burra, therën 180 sish, vranë 340 gra, therën 285 sosh, therën 701 fëmijë, kurse dogjën 705 sish. Nga të ftohtit vdiqën 103 vetë, u plagosën 359 burra dhe 275 gra, ndërsa u morën rob 251 gra e vajza, sikurse 16000 banorë i detyruan të lënë shtëpitë e tyre. Kishte shumë të drejtë ish-presidenti amerikan Xheferson , dy shekuj më parë, kur duke iu referuar Luftës Civile 20 vjeçare në Amerikë do të shprehej për forcat ndërluftuese: " Të gjithë pjesëmarrësit e asaj lufte 20 vjeçare duhen vlerësuar, sepse secili po luftonte për Amerikën sipas vizionit të vet" (Fadil Kraja "Mjeshtër i Madh", TV-Shkodra, janar 2015).

Kjo nuk do të thotë që, ne të gjithë, sikurse gjithë bota demokratike nuk duhet të dënojmë krahas komunizmit edhe nazifashizmin, si dy totalitarizma, katastrofë për njerëzimin,

Ajo që dua të theksoj është që, ne, shqiptarët, duhet ta kemi krejt të qartë që Bashkimi ynë me Evropën, aq më pak Bashkimi Kombëtar, amaneti i nacionalizmit shqiptar, Shqipëria Etnike, nuk mund të arrihen, kurrsesi, pa bashkimin tonë shpirtëror si komb , prandaj kërkohet të distancohemi përfundimisht nga përplasjet tragjike brenda vetes. Mjaft me vrasjet, ngujimet, përbuzjet apo përndjekjet politike. Monografi i pasionuar i fisit të Islamëve, filluar me monografinë kushtuar Rezah Selacit, promovuar 7 vite më parë, konstaton me shumë sinqeritet, respekt dhe dhimbje, në funksion të një rishikimi profesional të historisë sonë kombëtare, ndryshe në funksion të një komunikimi fisnik, civil, bashkëkohor, demokratik, mes vedit:

"Shpifën e çka nuk shpifën sllavokomunistët për Ahmet Selacin dhe idhtarët e tij. I quajtën pari kriminale, banditë, bashibozukë, lahutarë e çfarë jo tjetër. Kjo gjuhë komunikimi sot , jo vetëm është anakronike për kohën që jetojmë, por faktet tregojnë se Ahmet Se-

SOFRA E SHQIPES-PRIZREN 2015

KJO TREVESE U ORGANIZUA NGA TV "BLUE SKY" I CILI PO PREZANTOHET SI NJË VATËR E KULTURËS KOMBËTARE

Pas suksesit që "Blue Sky" me stafin e tij arriti për dy vite me radhë në organizimin e "Sofrës së Shqipes" për festat e fundvitit: të parën në qytetin e Shkodrës dhe të dytën në qytetin e Ulqinit, këtë radhë Shqipja e kësaj sofre fluturoj drejt Prizrenit.

N'at Prizren, n'at t'bukurin vend, n'at qytet të historisë dhe të zambakëve të bardhë Shqipja hapi krahët e saj për të mirëpritur edhe njëherë në këtë sofrë tradicionale vëllezër e motra nga të gjitha trevat shqiptare.

"Sofra e Shqipes", kështu është titulluar ky eveniment, ashtu si vetë Shqipja që mbledhë pranë bijt e vet edhe kësaj here mbledhi rreth saj shqiptarët, jo vetëm nga Shqipëria e Kosova, por ngado që jetojnë e punojnë.

"Sofra e Shqipes", u shtrua në "LUXURY PALACE" dhe ishte për një natë sofa e gjithë shqiptarëve dhe, ashtu siç është traditë në raste festash, buçitën këngët e bukura popullore dhe gazmoi humori i pastër shqiptar.

Këtë sofrë e nderuan me pjesmarrjen e tyre këngëtarët më të mirë të skenës shqiptare nga Shkodra, "Mjeshtri i Madh" Bujar Qamili, mbretëresha e këngës popullore shkodrane Vjoleta Zefi dhe si gjithmonë e freskët si lulet e pranverës këngëtarja Alma Velaj. Prishtina, "Mjeshtrja e Madhe" Shkurte Fejza e shoqëruar nga Naxhije Fejza motra e saj dhe nga vajza Gresa Behluli, Vlora, Rovena Ibrahim, Tirana, Elisabeta Marku dhe Eli Malaj, Tuzi, Nikoll Nikprelaj. Çamëria, Enkelejda e Hysni Alushi, Ulqini, Gëzim Salaj, Gjakova, legjenda e këngës kosovare Ismet Peja, Mitrovica, Gazmend Kelmendi, Malësia e Madhe, Skënder Xhafa dhe Vida Kunora, Puka Anjeza Ndoj, Treva e Dukagjinit u përfaqësua nga Gofile Papeleka, Ndue Shutani, Fran Kodra, Pëllum Vrinca dhe Gëzim Zefi, Diaspora Lap Logu, në "Luxury Palace" vetëm me "Blue Sky music" aty ku muzika buron nga shpirti, shoqëruar nga orkestra e këtij televizionit.

Humor e hajgare sollën në këtë sofrë të begatë humoristët e Estradës Profesionaliste të qytetit të Shkodrës me pjesmarrjen e aktorëve të mirënjohur të humorit shkodran si: Drande Xhai, Muhamet Çekini, Anton Krosaj, Bendis Druni si dhe grupi "Gaz e maraz" Qazim Çela dhe Gac Kodrina.

Siç thotë një fjalë e vjetër popullore "Burra të mirë zen sofa boll" dhe këto burra, gra, vajza e djem u ulen në këtë sofrë të gjithë të barabartë, siç i ka hije një sofre shqiptare.

TV "Blue Sky" i ftoi me kënaqësi që të vinin në këtë festë të madhe, të bëheshin pjesë e kësaj sofre bujare, të uleshin dhe të shijojnë në një natë magjike mikpritjen dhe kulinarinë tradicionale të Prizrenit, këngën e bukur shqiptare, gazin dhe hare-në që sjell humori, por mbi të gjitha atë që sjellin gjithmonë trevesat mikpritëse, takimin dhe çmalljen mes vëllezërish, motrash, miqsh e shokësh.

Pas interpretimit të himnit të TV "Blue Sky" moderatorja e mirënjohur e këtij televizionit Adelajda Tukiqi, drejtuese e

këtij spektakli, pasi falenderoi Presidentin e TV "Blue Sky" z.Gëzim Brahusa i cili i kishte besuar drejtimin e këtij spektakli, uroi mysafirët pjesëmarrës, si dhe bëri një përshkrim të përmbledhur për punën me mjaft profesionalizëm dhe sukseset e njëpasnjëshme të këtij televizionit, duke vijuar më pas me prezantimin e programit.

I pari që u ngjiti në skenë e improvizuar me aq shije për këtë mbrëmje ishte legjenda e këngës kosovare Ismet Peja, i cili përmes emocioneve të moshës së thyer para se të këndonte, falenderoi organi-



zatorët e kësaj mbrëmjeje magjike, duke ia lënë radhën më pas "Mjeshtrit të Madh" Bujar Qamili, i cili bëri publikun të ngrihej në këmbë dhe të gjithë e shoqëruan duke kënduar së bashku. Interpretimi dhe performanca para publikut, forca brenda tij për të prekur zemrat e të gjithëve nuk shterron. Ai vjen gjithnjë me risi dhe i palodhur, për të vazhduar pasionin që e udhëhoqi përgjatë gjithë jetës së tij. Bujar Qamili është këngëtar, shoëmen me kuptimin e plotë të fjalës, një artist i mirfilltë ku artin e ka ushqimin e shpirtit dhe atë që e mban gjallë.

Pas këngës "Qejfi bahet me shkodranë" që tashmë është bërë pjesë në repertorin popullor për festa e gëzime, ai solli edhe këngë të tjera shumë të dashura për publikun, duke u ndjekur më pas nga interpretimet brilante të shumë e shumë këngëtarëve të ftuar në këtë sofrë.

Humori i gërshetuar me këngë e valle i dhanë akoma më shumë gjallëri kësaj sofre madhështore.

Trevesa qëndroi e shtruar gjerë në orët e para të mëngjesit, pa i rënë për asnjë çast ritmi dhe gjallëria, sepse këtë ritëm e gjallëri nuk ia jepnin vetëm këngëtarët e humoristët, por të gjithë të pranishmit që ishin pjesë e kësaj trevese.

Natyrisht kjo trevese shqiptare mori vlerësime nga personalitete të ndryshme që ishin të ftuar aty, të cilët nëpërmjet intervistave që i morëm, shprehën lavdëratat dhe emocionet që përjetuan në këtë natë magjike.

Drejtori i "LUXURY PALACE" z.Armend

Berisha tha se e kishte pritur me kënaqësi ofertën nga Presidenti i TV "Blue Sky" z.Gëzim Brahusa për të organizuar në lokalit të tij "Sofrën e Shqipes", duke u ndjerë i privilegjuar nga kjo ofertë, pasi një aktivitet i tillë nuk ishte organizuar asnjëherë në qytetin e Prizrenit.

Stafi ynë, tha ai, u përkushtua shumë me qëllim që gjithçka të ishte në funksion të mbarëvajtjes së këtij eventi të pa harruar jo vetëm në lokalit tonë, por për të gjithë qytetarët e Prizrenit.

Janë mysafirët ata që na dhuruan buku-

Vlora, Çamëria, Mitrovica, Malësia e Madhe, Malësia e Pukës, d.m.th. të gjitha trevat shqiptare, si dhe Diaspora, kishin këngëtarët e tyre".

Jemi me legjendën e këngës popullore mbarë shqiptare Ismet Peja. Unë iu drejtova ashtu siç e thërrasin kosovarët: Baca Ismet, si e vlerësoni këtë mbrëmje kaq të madhe?

Ishte një mbrëmje e pa harrueshme, ku janë mbledhur të gjithë ata që kanë kontribuar dhe kontribuojnë me vite për këngën gjithëshqiptare. Jam tejet i kënaqur që si legjendë e këngës gjithëshqiptare mora pjesë në këtë eveniment të iniciuar nga z. Gëzim Brahusa, drejtor i TV "Blue Sky" të cilin e përshëndes dhe i dëshiroj çdo të mirë dhe punë të mbarë e suksese.

Z. Nikoll, si e pritët ftesën nga TV "Blue Sky" për të marrë pjesë në "Sofren e Shqipes", iu drejtova këngëtarit Nikollë Nikprelaj nga Tuzi.

"Me erdhi mirë që mu bë ftesa për të marrë pjesë në "Sofren e Shqipes". Unë si këngëtar, gjeografikisht i përkas kësaj treve edhe pse ndoshta jam më shumë prezent në skenat kosovare. Unë çdo ditë e më shumë po paraqitem para publikut të Shqipërisë për çka jam shumë i interesuar. Unë jam malësor dhe si malësor përpiqem kudo ta përfaqësoj melosin tonë kaq të pasur dhe kaq të bukur.

"Sofra e Shqipes" u organizua bukur. Bukurinë e kësaj sofre e sollën vjet e këngës mbarëshqiptare siç ishin Ismet Peja, Bujar Qamili, Shkurte Fejza etj. Ideja që çdo vit të mbahet në vende të ndryshme kjo trevese gjithashtu me duket një gjetje interesante, aq më tepër që u mbajt në Prizrenin e bukur".

Vitin e kaluar ju përfaqësua denjësisht Trevën e Tuzit në festivalin e këngës popullore qytetare organizuar nga RTSH.

"Po. Vitin e kaluar mora suksesshëm pjesë në festivalin e këngës popullore në RTSH. Atje u paraqita me një këngë të kompozitorit Edmond Zhulali dhe me një këngë popullore me titull "Po martohet malësori".

Me çfarë këngësh u paraqitët sonte?

"Sonte u paraqita me një këngë të vjetër shkodrane "Karajfil të zgjodha" dhe një këngë të re nga Edmond Zhulali me tekst timin "Dashuri që nuk mbaron". Edhe ky tekst bën fjalë për një bukuroshe shkodrane".

Si e ndjetë veten mes kolegëve tuaj në këtë natë magjike?

"Si u ndjeva? Gjithmonë ndjehem mirë aty ku ka artistë të mëdhenj. Shpresoj që edhe të tjerë këngëtarë që ishin pjesëmarrës në këtë sofrë të bëhen të mëdhenj. Këngëtarë bëhet i madh vetëm nëse punon shumë, kultivon artin e pastër dhe bën përpjekje të bëjë një fizionomi të veten përmes interpretimit sa më original dhe të veçantë. Uroj që edhe "Blue Sky" të ec' përpara me një program të pastër origjinal adhtu siç i ka hije një Shkodre, e cila njifet si vatër kulture në gjithë kombin tonë".

Në mes këngëtarëve dhe mysafirëve, tentova t'i marrë një opinion edhe këngëtares nga Çamëria Enkelejda Alushi-Arifi: Si e pritët ftesën nga Tv "Blue Sky" për të marrë pjesë në këtë sofër?

"Të them të drejtën ftesën e prita me kënaqësinë më të madhe. Më erdhi shumë mirë dhe u ndjeva e nderuar nga ftesa që më bëri z.Brahusha. Më në fund edhe Çamëria do të përfaqësohej nga unë dhe Hysniu. E cili Shqiptar nuk do të donte të ulej në "Sofren e Shqipes".

Është hera e parë që ju merrni pjesë në këtë eveniment?

"Po, është hera e parë që unë jam pjesë e kësaj ngjarje të madhe dhe të them të drejtën e shijova shumë bukurinë dhe kënaqësinë e të qenit pjesë e këtij spektakli mbarëkombëtar, që bashkon artistë nga të gjitha viset tona. Siç e thash edhe më heret për mua ishte më shumë se magjike kjo natë, sepse u ndjeva shumë mirë mes kolegësh artistë të të gjitha viseve, gjë që ndodh rrallë të jemi të gjithë bashkë, sepse secili është i zënë me aktivitetet e tij profesionale dhe sofa na bashkoi".

Si e vlerësoni ju këtë natë magjike, cili ishte momenti më i bukur për ju?

"Momenti më i bukur për mua ishte kur gjatë performimit tonë u ngritën të gjithë pa përjashtim e na rrethuan duke vallëzuar në ritmet e bukura të këngëve çame. Nuk më respektuan e nderuan vetëm mua dhe Hysniu, ata të gjithë pa përjashtim respektuan dhe nderuan tërë Çamërinë, e cila më shumë se kurrë ishte pjesë e asaj «Sofre Shqiptare». Edhe një herë dëshiroj të falenderoj z.Gëzim Brahusha, TV «Blue Sky» për ftesën dhe të gjithë të pranishmit, përfshirë edhe kolegët artistë për pritjen fantastike që na bënë atë mbremje».

Nuk kishte si të mungonte edhe ikona e këngës shqiptare e madhja Shkurte Fejza, të cilës nxitova t'i marrë edhe asaj opinionin për këtë trevese madhështore shqiptare.

Zj. Shkurte, atmosfera e festimit të 40 vjetorit të karrierës tuaj para disa ditësh vazhdon të jetë akoma e ngrohtë. Ju jeni e vetmja këngëtare kosovare që jeni dekoruar nga dy Presidentë, i Shqipërisë dhe e Kosovës me titullin "Mjeshtre e Madhe" dhe "Medalje Presidenciale e Meritave".

Së pari, e filluam bisedën me këngëtarën e madhe Shkurte Fejza, ju falenderoj që gjetët kohë të na nderoni me pjesmarrjen tuaj në këtë eveniment kaq të madh, së dyti desha t'ju pyes si e pritët ftesën nga Presidenti i TV "Blue Sky" z. Gëzim Brahusha për të qenë e pranishme sonte në këtë sofër madhështore?

"Është e vërtetë që ende unë jam në atmosferën e gëzimeve, ku po i korri sukseset e 40 vjetorit. Kjo më bën të ndjehem e relaksuar, pasi nuk e kam më ngarkesën e organizimit, tash po e shoh se ishte bukur, tash po e shoh se më kanë nderuar miq nga të gjitha trojet shqiptare, miq nga Diaspora dhe lum ai që ka miq, sepse pa miq e dashamir nuk ka kuptim as jeta. Pikërisht ky motiv ka ndikuar që unë të jem këtu, sepse Gëzimin, Presidentin e TV e kemi mik dhe më ka pëlqyer organizimi që vazhdimisht e bën për sofrën shqiptare, më ka pëlqyer se janë artistë nga të gjitha trevat shqiptare dhe jam ndjerë e privilegjuar në mesin e këtyre artistëve. Atmosfera po më pëlqen shumë, do kisha thënë lum ai që po e shijon dhe më vjen keq për ata që nuk kanë patur mundësi për me ardhë që ta shijojnë. Më vjen mirë që u kënduan këngë shumë të bukura nga këngëtarë të ndryshëm duke përfaqësuar denjësisht vendet e tyre nga vijnë, këngë të vjetra dhe të reja, gjë e cila po më pëlqen shumë".

Krahas suksesit të padiskutueshëm që ju keni gjithmonë në çdo eveniment, sonte u vu re edhe pjesmarrja e motrës dhe vajzës tuaj. Ju lutem na thoni diçka rreth performancës së tyre.

"Po, ne jemi familje që të gjithë kanë kënduar, duke u nisur prej vehtes time,

por edhe prindërit e mij kanë kënduar, duke vazhduar edhe me shtatë motrat e mia, të cilat sa herë mblidhemi krijojmë atmosferë, pasi në familjen time është një traditë që të këndohet. Më së shumti këtë e dëshmon motra ime Naxhija edhe Gresa, vajza ime për të cilat ju them të drejten se kur dalin ata të këndojnë, unë jam shumë e lumtur, sepse kanë zë shumë të bukur.

Së fundmi më lejoni që të përshëndes për zemërsisht të gjithë adhuruesit e mi kudo që ndodhen".

Jemi me këngëtarën nga Vlora, Rovena Ibrahim. Ju lutem, iu drejtova asaj, na tregoni si e pritët ftesën për të qenë e pranishme në "Sofrën e Shqipes" në qytetin e bukur të Prizrenit?

"Në radhë të parë dua të përshëndes organizatorët e këtij spektakli siç është TV "Blue Sky" i cili meriton një duartrokitje të madhe, sepse përveç një sofre të zakonshme që mund të bëhej në prag të vitit të ri, ka bërë një përzgjedhje shumë të bukur midis trevave të ndryshme shqiptare. Kemi folklor shumë të bukur, kemi melodi të ndryshme popullore, flasim të gjithë shqip. Kjo ishte gjëja më e bukur që mua më pëlqeu.

Ndjehem shumë e vlerësuar, sepse të jesh përkrah emrave të mëdhenj të muzikës shqiptare, ato emra që kanë bërë epokë në muzikë nuk është pak. Të jeshë në mes Ismet Pejës, Shkurte Fejzës, Bujar Qamilit dhe gjithë këngëtarët me radhë, ishte një vlerësim shumë i madh. Pra është një vlerësim akoma më i mirë sepse unë vij në Prizren mbas çmimit të parë të festivalit "Zambaku i Prizrenit" dhe të rikthehesha prap në Prizren, në këtë sofër kaq të bukur, do të thotë një festë e dytë për mua".

Si e ndjetë veten sonte në këtë eveniment?

"Sigurisht që u ndjeva shumë mirë, fjalët e para i thashë se unë jam një vlonjate, e para që marr çmim në Prizren.

Ç'mund të them tjetër veçse një falenderim, jo vetëm Prizrenit për këtë mikpritje që bën gjithmonë me të gjithë artistët, por faleminderit edhe TV "Blue Sky", stafit të tij, që bëri këtë organizim kaq të bukur me kaq zgjedhje domethënëse në qytetin e Prizrenit".

Për t'i marrë opinionin edhe "Mjeshtrit të madh" Bujar Qamili e pata më të lehtë, pasi me të, të nesërmen udhëtova për në Shkodër, prandaj po e lë edhe në mbyllje të shkrimit.

Biseda ishte interesante, pasi atë e bëmë në makinë gjatë rrugës së kthimit. Bujari herë shikonte rrugën dhe herë mua dhe e filloi bisedën me humor: Tash e gjete Zan me më marrë në intervistë? Po ndalemi në Kukës, pijmë një kafe edhe po bajmë muhabet.

Ashtu bëmë edhe opinionin i Bujarit ishte Ky: "Ishte një spektakël që ndryshoi nga dy vitet e tjera. Me shkathtësinë dhe talentin e tij, z.Gëzim Brahusha me stafin e tij kishte vendosur që kësaj here ky eveniment të organizohej në një nga qytetet më të bukura të Kosovës, siç është Prizreni.

Unë jam shumë i kënaqur që mora pjesë në këtë sofër të madhe, ku u takova dhe u përshëndeta me koleg dhe miq të mi, të cilët kisha kohë pa i takuar.

Përsa i përket spektaklit, ai ishte i realizuar me një regji spektakulare që nuk ke se çfarë t'i shtosh, sepse deri në orët e para të mëngjesit, mysafirët nuk lëviznin nga ai ambient i mrekullueshëm, pasi atmosfera ishte në kulmin e saj dhe këtë e bënte të tillë repertori i mirëfilit shqiptarë".

Shfaqja e sofrës fluturoi e gëzuar dhe krenare mbi qiellin e Prizrenit për t'i lënë vendin sofrë së radhës, që vitin e ardhshëm të shtrohet në një qytet tjetër shqiptar, për të mbledhur përsëri bijtë e bijat e veta, ashtu siç i ka hije një nëne fisnike.

**Përgatitë nga
RAMAZAN ÇEKA,
nëntor 2014**

GIJAKUI SELACËVE DO TË NDRIJË NDËR SHEKUL..

vijon nga faqja 9

lacidit, këtij tribuni popullor, si shumë nacionalistëve të ndershëm, halë në sy për OZN-ën jugosllave, koha i dha të drejtë, ai arriti të triumfoi mbi rrethanat duke u bërë mal në sytë e popullit të tij".

Lidhur me këto, që sapo thashë, dua të nënvizoj: Sot jetojmë në Epokën e Pashistorisë, që do të thotë se iku koha e fronteve, koha e përplasjeve mes vedi, pra nuk duhet të biem kurrsesi pre' e lojës me historinë: "Komunisti apo ballisti, partizani apo nacionalisti, heroi apo kuislingu". Në Epokën e Integritit dhe të Shoqërisë së Hapur historia shijohet vetëm si turizëm historik. Historinë dje e bënin heronjtë, posthistorinë sot e ndërtojmë secili. Fatmirësisht ky është edhe kodi i komunikimit me vetveten dhe mjedisin shoqëror, i njërit prej trashëgimtarëve më fisnikë të selacëve të Shalës së Bajgorës, i trajtuar me aq respekt në këtë libër, sponsorizuesi i botimit dhe i promovimit të këtij libri, i dyti pas atij kush-tuar Rezahut dhe promovuar 7 vite më parë, zoti Bejtush Selaci, djali i Rezahut.

Duke manifestuar zotësinë, urtësinë,

orientimin pragmatist, por edhe atë human si sponsorizues, i nderuari Bejtush Selaci ka arritur të ndërtojë, jo si qaraman, por me dinjitet jetën e vet si qytetar dhe familjar, si biznesmen bashkëkohor dhe patriot iluminist, duke u lënë brezave që vinë, të promovuar, një pasuri serioze si kontributi i shkëlqyer historik i 4 brezave të fisit Islamëve, që falen gjithçka, në emër të kombit, apo siç shprehej aq madhërisht Rezahu:

"Gjakun Kosovës, jetën Shqipërisë". Ne shqiptaret që ende nuk e kemi zgjidhur çështjen tonë kombëtare, nuk na lejohej të injorojmë amanetin e nacionalistëve të vërtetë, sepse "Trepça" për të cilën u investua aq shumë Ahmet Selaci, i mbështetur kurdoherë nga kushërinjtë e tij Rezahu, Mahmuti, Rexhepi, Ajeti, Ileri etj. sikur edhe nga nënat dhe motrat selaciane, që derdhën aq lotë gjaku, lot shpirti kur i masakruan, akoma s'ka gjumë...

Kosovarët po ikin nga Kosova, sepse "Trepça", e njohur botërisht si Kombinati i Trepçes, edhe pse ndodhet në tokën e Kosovës, vazhdon të mos qeveriset nga shqiptarët, ndryshe nuk ka shpëtuar

ende prej lakmive të vjetra... Kujtoni! Jo rastësisht, më 24 qershor 1999 francezët, njëri nga investitorët e huaj në Mitrovicë, pasi zbritën nga ajri, do të ishin të parët që do të ngrinin barrikadat e para mbi Urën e Ibrit, ndërsa rusët zbritnin në Prishtinë me qëllim që serbët të mos humbnin shpresat e një perspektive optimiste!

Mos harroni vëllezër dhe motra kosovare: "Kali i Trojës" sot vërtet nuk e ka veshjen prej druri, por asgjë s'ka ndryshuar në thelbin e tij. Shqiptarët e Kosovës nuk duhet t'ia lejojnë vetes që, "Bashkim-Vëllazërimin" hipokrit të së djeshmes, ta zëvendësojnë me Entuziazmin modern, mashtrues, të Perandorisë së Tregut, aq më tepër kur edhe sot: "ka një doktrinë në Ballkan, që titullohet "Dëbimi i shqiptarëve", një draft të vitit 1938, shkruar prej akademikut serb, Vaso Çubrilloviçit," i cili kërkon dëbimin e shqiptarëve prej gadishullit.

Një projekt kriminal, që nuk di të jetë dënues në Jugosllavi, as ish-Jugosllavi, - thekson akademiku ynë I.Kadare "Nderi i Kombit",- vënie e të cilin në jetë në vitin 1999 e pa gjithë bota' ("Mosmarrëveshja-raporti i shqiptarëve me vetveten", fq.77). Megjithatë s'duhet harruar as ana tjetër e medaljes: Atdheun e dua sa të më dojë ai mua. Ky është vizion i njeriut modern, aq më shumë kur premtimet

elektorale mbeten në fasadë sikurse shifrat tejet shqetësuese të papunësisë dhe të varfërisë në Kosovë njohin vetëm dhe vetëm rritje. Në këtë kontekst duhet të jemi të tej ndërgjegjësuar se pa dashur vetveten nuk të do askush në këtë drejtë bote. Mjerë ai popull që harron historinë, dhimbjet dhe sakrificat për një jetë në liri, ku shkëlqyen figura të tilla heroike si: Ahmet Selaci, komandanti i divizionit "Ibri" i ushtrisë nacionaldemokrate shqiptare të "Besës Kombëtare", që do të sakrifikohej gjithë jetën me idealin e shenjtë: "Shqipëria Natyrore e shqiptarëve". Mjerë ai popull që, i dehur nga entuziazmi modern, vijon të mos i gëzohet vetvetes, tokës amë, por Dyerve të Botës! Duke përfunduar dua të uroj autorin e librit z. Asllan Istrefi, të vijojë me monografitë e fisit të islamëve, bij të shquar të kombit tonë. Po ashtu, personalisht, kam kënaqësinë të përulë me respekt para z.Bejtush Selaci, patriotit iluminist, djalit të Rezah Selacit, që me sponsorizimin e vet shembullor ka vendosur t'u lërë pasardhësve të selacasve legjendarë dhe kombit të vet, veprën e tyre historike, veprën e një gjaku që do të ndrijë ndër shekuj, historinë e Ahmet Selacit, histori nderi dhe krenarie kombëtare.

nga Kadri Ujkaj

ALEKSANDRI I MADH

“Unë jam Ilir”



Studiuesja e shqar italiane Lucia Nadin ka zbuluar një testament të Aleksandrit të Madh në të cilin ai i drejtohet popullit të Shkodrës duke ju dhënë atyre një territor në administrim si dhe duke ju drejtuar me fjalën se ai është “pinjoll i farës së ilirëve”.

Dokumenti është publikuar nga studiuesja italiane e cila ka bërë një hulumtim shkencor për Aleksandrin e Madh.

Në letrën e dërguar shkodoranëve, Aleksandri i Madh shkruan:

“Unë Aleksandri, bir i Filipit, mbretit të maqedonasve, mishërim i monarkisë, krijues i Perandorisë Greke, biri i Zeusit, bashkëbisedues i Brahmanëve dhe i Pemëve, i diellit dhe hënës, triumfues mbi mbretëritë e Persëve e të Medëve, Zoti i Botës prej ku lind dhe ku perëndon dielli, nga Veriu në Jug, pinjoll i farës së shqar të popujve Ilirikë të Dalmacisë dhe Liburnisë dhe të popujve të tjerë të së njëjtës gjuhë që popullojnë Danubin dhe zonën qendrore të Thrakës, u sjell dashurinë, paqen dhe përsëritjet e mija dhe të të gjithë atyre që ndjekin sundimin e botës.

Duke qenë se ju gjithmonë me jeni treguar të besës dhe të fortë e të pathyeshëm në betejat e bëra krah meje, u jap dhe u dorëzoj juve në zotërim të lirë gjithë hapësirën e Akuilonit e deri në skaj të Italisë së Jugut. Askush tjetër, veç jush, të mos guxojë të vendoset dhe të qëndrojë në ato vende dhe po u gjet ndonjë i huaj, ai do të mund të qëndrojë vetëm si skllavi i juaj, dhe pasardhësit e tij do të jenë skllavër të pasardhësve tuaj”.

U shkrua në Kështjellën e qytetit të Aleksandrisë, themeluar prej meje buzë lumit madhështor të Nilit në vitin XII. Me vullnet të perëndive që nderohen në mbretëritë e mia, Zeusit, Marsit, Plutonit dhe Minervës, perëndisë së perëndive. Dëshmitar të këtij akti janë Atleti, logotheti i im, dhe 11 princa të tjerë, të cilët unë po i emëroj si trashëgimtarë të mi dhe të të gjithë Botës, meqenëse po vdes pa lënë pasardhës.

Burimi: Balkanweb



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI

